Gjate punes per ndertimin e ketij Hidrocentrali, germimet per hapjen e trasese per ndertimin e kanalit/tubacionit te derivacionit dhe instalimin e tubacionit nen presion do te ngrihen pluhura, vecanerisht gjate sezonit me thatesire. Keto pluhura, ndikojne negativisht jo vetem ne peizazhin e perkohshem te zones, por edhe ne floren dhe faunen e zones. Depozitimi i pluhurit ne shtrese te madhe ne gjethet e pemeve, shkakton veshtiresi te proceseve jetesore te bimeve, kryesisht ne procesin e fotosintezes dhe te ushqimit te bimeve. Ndikimi ne peizazh konsiston ne ngritjen e pluhurit pergjate trasese se tubacionit dhe ne rruget auto. Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkimeve te gazeve te demshme per ajrin, por keto shkarkime nuk do te jene ne nivele te larta (krahasimisht me shkarkimet qe clirohen nga cdo mjet tjetër transporti qe funksionon me lende djegese hidrokarbure me motorre me djegie te brendshme). Gjate punimeve nuk rezulton se do te kete perdorim te lendeve plasese, vetem perdorim te eskavatoreve dhe te çekiçeve pneumatike. Zhurmat nga mjetet e punes jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonat e banuara, pasi ato ndodhen ne largesi. Kryesisht zhurmat shkaktohen nga germimet e masivit te shkembit kryesisht nga perdorimi i çekiçeve pneumatike aty ku materiali tokesor eshte i forte. Nuk pritet te kete vibrime, sipas projektit te zbatimit, nuk do te perdoren lendet plasese. Tubacioni i presionit do te shtrihet pergjate shpatit te kodrines e cila ndodhet ne anen e majte te lumit kardhiq, pak para se te filloje aktiviteti i rritjes intensive te peshqve qe ndodhet ne kete zone. Punimet do te kryhen ne nje siperfaqe toke me bimesi shkurre, relativisht te zhveshur per kanaline e derivacionit dhe pjeserisht te dendur per tubacionin nen presion, si rrjedhoje parashikohet te kete demtime te siperfaqeve pyjore, por ne nivele te moderuara. Rruga e cila do te mundesoje aksesin me mjete transporti per tek objekti i Hidrocentralit, eshte ekzistuese, mund te perdoret rruga qe kalon prane vaskave te akuakultures per tek godina e Hidrocentralit, si dhe rruga e fshatrave dhe shtrati i gjere i lumit per tek vepra e marrjes dhe kanali i derivacionit.

Rruga për tek vepra e marrjes është ekzistuese deri aty pranë, ndërsa transporti i materialeve përgjatë kanalit ku do të instalohet kanali dhe tubacioni, do të mundësohet nepërmjet trasës që do të çelët për ndërtimin e kanalit dhe shtrimin e tubacionit. Gjatesia e kanalit do të jetë maksimumi 850 metër lineare, ndërsa gjatesia e tubacionit të presionit do të jetë rreth 430 metër lineare. Demtimi i bimesisë, sado i moderuar të jetë (vetëm 430m të tubacionit ka bimesi) ndikon në uljen e cilësisë së ajrit, (sepse bimët shërbejnë si asimilues të Dioksidit të Karbonit dhe riciklues të Oksigjenit). Gjate funksionimit të HEC-it, reduktimi i ujit të burimit, mund të ndikojë në ndryshime të mikroklimës së zonës, por ky efekt, vetëm në rast se nuk respektohet rrjedha ekologjike dhe fikja e turbinave gjatë stinës me thatësirë (Qershor-Tetor). Nga të dhënat teknike paraqitet se kjo veprë hidrike do të funksionojë rreth shtatë muaj të vitit (sipas projektit hidroteknik të paraqitur, do të punohet rreth 4870 orë/vit). Nëse do të kryhet edhe rehabilitimi i plote të sipërfaqeve pyjore të demtuara, sipas projektit të rehabilitimit, ndikimet do të jenë minimale. Rehabilitimi duhet të kryhet gjatë dhe pas përfundimit të punimeve ndërtimore. Megjithatë, për të parandaluar efektin negativ në mjedis nga punimet ndërtimore, duhet të merren masa parandaluese të tilla si ndërtimi i pritave ekologjike me dru për të mbajtur dheun e germuar nga traseja, duke mos lejuar përhapjen e tij në të gjithë shpatin e kodrinës dhe të përfundojë në shtratin e lumit, ku rrjedha ujore e shpërndan atë me tëj në burimin ujor prites.

Ndikimet në ajër, ujë apo edhe tokë nga ky projekt janë edhe pozitive, përse kjo në një aspekt tjetër të prodhimit të energjisë së rinovueshme dhe miqësore me mjedisin. Në rast se do të krahasonim teknologjinë e përdorur për të prodhuar të njëjten sasi energjie elektrike nga një Termocentral me lëndë djegëse qymyr guri, hidrokarbure, apo përdorim me lëndë të rrezikshme radioaktive, ky lloj instalimi është me miqësor me mjedisin.

Linja e transmetimit që do të ndërtohet duke lidhur HEC Plesat me nënstacionin me të afërt, nuk do të ketë demtime të rëndësishme në mjedis, kjo pasi do të instalohen vetëm disa shtylla dhe do të jetë linjë ajrore për transmetimin e energjisë elektrike. Për ndërtimin e linjës nuk do të ketë germime e hapje rrugësh të reja, do të përdoren ato ekzistuese. Ndërtimi i linjës nuk demton bimesi të lartë, nuk është linjë e tensionit të lartë. Për faunën e rajonit nuk përben shqetësim ndërtimi i linjës së transmetimit.

Ndikimet në ujëra (Ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore.)

Nga zbatimi dhe funksionimi i këtij projekti, ndikimet në ujëra do të jenë prezente dhe të rëndësishme. Gjatë fazës së kryerjes së punimeve ndërtimore, ndikimi në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore do të vijë si rrjedhojë e punimeve në sipërfaqe për hapjen e trasës dhe instalimin e kanalit të derivacionit dhe tubacionit nën presion. Hasja e burimeve ujore gjatë germimeve ose çpimeve, do të shkaktojë daljen në sipërfaqe të ujërave nëntokësore, fenomen i cili mund të shoqërohet edhe me erozion e shpëlarje të tokës, varferim të ujërave nëntokësore dhe ndotjen e ujërave sipërfaqësore të burimeve të zonës. Për shkak se punimet do të kryhen në sipërfaqe, duke mos kaluar në asnjë rast germimet në thellësi 5-7m, këto fenomene probabilitet nuk janë të mundura. (Këto fenomene janë prezente kryesisht në rastet e hapjes së tuneleve). Gjatë punimeve të ndërtimit, mund të ndodhë që burimi ujor (Lumi Kardhiq) të kontaminohet me material tokësor duke shkaktuar turbullirë të perkohshme (Lëndë të Ngurte në Pezulli). Punimet rehabilituese do të minimizojnë ndjeshëm këto impakte. Gjatë funksionimit të Hidrocentralit, do të merret një sasi uji e cila do të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike. Kjo sasi uji, në raport me prurjen mesatare është relativisht e lartë.

Gjithashtu, sipas projektit të shfrytëzimit do të respektohet rrjedha ekologjike e perroit e cila është perlloritur rreth $0.17 \text{ m}^3/\text{sek}$. Që në raport me prurjen mesatare është diku tek 4%. Sasia e nevojshme e ujit gjatë sezonit me thatësire, si për çështjet ekologjike ashtu edhe për çështjet e turizmit, bujqësisë, etj, është shumë më e lartë.

Sipas projektit të shfrytëzimit, deklarohet se do të punohet vetëm 4870 orë/vit, pra rreth 7 muaj/vit, kjo në shtrirje kohore për gjatë gjithë vitit!!!. Një ndikim tjetër i rëndësishëm në lidhje me ujërat, është edhe efekti negativ i këtij projekti në hidrobiologjinë lumore (flora dhe fauna ujore). Në rast se do të kryhen punimet rehabilituese në masën e duhur dhe në kohën e duhur, si dhe të respektohet rregullisht periudha e funksionimit pra vetëm 7 muaj/vit në periode të rregullt stinore/vjetore, që do të thotë se 5 muaj nuk duhet të funksionojë fare si central, ndikimet do të jenë minimale dhe nuk vlerësohen me dëmtime të rëndësishme në mjedisin e zonës.

Në këtë burim ujor, për shkak të sasisë së ujit, të relievit të cilesive të ujit, nisur nga kushtet klimaterike dhe të regjimit ujor, vlerësohet se ka prani të peshqve, ku specia e ujërave të embla dhe të ftohta malore është trofta, veçanërisht Mustaku i Ballkanit (Barbus rebeli), i cili është specie me status mbrojtjeje. Në këto kushte, ku në mënyrë institucionale nuk ka asnjë informacion për hidrobiologjinë e këtij burimi ujor, veçanërisht për floren iktike, në kushtet kur nuk ka edhe kontakt me studiues privat të cilët të këne kryer studime specifike dhe të këne informacione të sakta nuk kemi, prania e peshqve ose jo, ana sasiore e llojore ngelet në vlerësim teorik, e pa faktuar, por duke ju referuar kushteve mjedisore të këtij burimi ujor, faktit që është dege direkte e Lumit Drinos dhe indirekt e Lumit Vjose, si dhe duke kryer intervista në terren nga banorët e zonës, arrijmë në këtë konkluzion, se ka prani të troftës së eger.

Më sasinë e prurjes ekologjike, e cila sipas llogaritjeve të ligjit aktual në fuqi, nuk justifikon mbijetesën e gjallesave, gjatë sezonit me thatësire do të ishte shkatërruese për floren dhe veçanërisht faunën ujore. Në vlerësimin tonë, rrjedha ekologjike duhet të jetë në masën 33.33% të prurjes mesatare vjetore. Në këtë rast, prurja ekologjike e pershtatshme do të ishte $1.4 \text{ m}^3/\text{sek}$. Në këto kushte, funksionimi i vepres vetëm gjashtë-shtatë muaj/vit është një faktor pozitiv i cili ruan vlerat ekologjike të këtij burimi ujor dhe do të lejonte zhvillimin e plotë të këtij projekti. Përsa i përket burimit ujor kryesor të zonës i cili është Lumi Vjose, ky projekt, në të tilla përmasa. Në pjesën e sipërme të rrjedhës së këtij lumi, vlerësohet të ketë prani të peshqve, kjo pasi është ndër habitatet më të pershtatshme për shumimin e këtyre llojeve peshqish. Megjithatë, për të parandaluar futjen e peshqve në tubacionin nën presion dhe me pas turbinën e si rrjedhojë dëmtimin e tyre, në basenin e presionit/dekantuesin e vepres së marrjes duhet të vendosen rrjeta të imeta. Baseni dekantues shërben si pastrues i ujit nga sendet dhe papasteritë dhe njëkohësisht si parandalues i futjes së peshqve në tubacion.

Pershkrim i burimit ujq dhe gjendjes se biodiversitetit.

Lëvizja e ujit në të gjithë peisazhin dhe pellgun ujq ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ekologjinë e lumenjve në shkallë të gjërë hapësinore dhe kohore. Madhësia dhe forma e shtratis lumor, shpërndarja e pellqeve dhe tributarëve, si dhe qëndrueshmëria e substratis, të gjithë këto elemente përcaktohen nga ndërveprimi mes regjimit të rrjedhës dhe të gjeologjisë e natyrës së tokës.

Shumë lloje peshqish shfaqin një preferencë të caktuar për lloje të veçanta të habitatit të tilla si pellqe, përrenj ose zona moçalore. Në mjaft raste pasuria llojore faunistike rritet me rritjen e kompleksitetit të vendbanimit, me thellësinë, shpejtësinë dhe të mbulesës si ndryshoret më të rëndësishme që rregullojnë këtë marrëdhënie. Struktura e përbërjes llojore iktike (dmth, përbërja taksonomike dhe shpeshësia e pranisë) është gjithashtu e lidhur fort në strukturën e habitateve. Duke pasur parasysh marrëdhëniet e shpesh cituara në mes të rrjedhës, strukturës së habitateve dhe peshqve, nuk është e çuditshme se modifikime të regjimit të rrjedhjes ndikojnë në larminë biologjike të peshqve dhe organizimin funksional të komuniteteve iktike në lumenjtë me rrjedhje të rregulluar. Lloje të tilla, me kërkesa specifike habitatesh cilësisht të ndryshme për fazën e riprodhimit, lëshimit të vezëve dhe faza të tjera të jetës perballen me stres në fazën e devijimit të burimit ujq dhe ndryshimin e regjimit hidrologjik. Në këto faze të gjendjes së burimit ujq, nuk ka ndryshime llojore iktike. Specia me e përhapur apo që mund të kultivohet në këto lloje e kushte hidrologjike e të burimit ujq është Trofta (*Salmo faroides*), ose Mustaku i Ballkanit (*Barbus rebeli*).

Vlerësimi i habitateve dhe implikimet nga ndërhyrjet humane

Roli i tipit të habitateve akuatike, substratis, vëllimit të ujit dhe mënyrës së rrjedhjes janë esenciale në përcaktimin e ndikimeve në larminë biologjike dhe sidomos në faunën iktike. Në situatën e pranisë së llojeve salmonidae kjo analizë është tejet e rëndësishme për shkak të plasticitetit të kufizuar dhe kërkesave rigorozë për oksigjen dhe sasi uji si për format adulte ashtu edhe për rasatet.

Habitat e llojeve iktike mund të përcaktohen në mënyrën më të saktë duke marrë parasysh ato pjesë të mjedisit ujq nga të cilët gjallesat varen direkt ose indirekt, në mënyrë që të kryejnë proceset e tyre të jetës. Në këtë situatë duhet të plotësohen tre kërkesa themelore për të plotësuar nevojat e llojeve për të kryer proceset e tyre të jetës. Llojet iktike duhet të kenë ushqim, të jenë në gjendje për tu riprodhuar dhe të kenë habitate / mbështetjen për të mbrojtur veten nga grabitqarët apo kushtet e vështira mjedisore të tilla si flukset e larta / përmbytjet, ose kushtet e thatësisës, rrjedhës së kufizuar (të cilat mund të korrespondojnë me thellësi të kufizuar të ujit dhe oksigjenit të ulët të lidhur me temperatura të larta në muajt e verës). Cilësitë biologjike, kimike dhe fizike të përrenjve, lumenjve dhe liqeneve përdoren nga peshqit për të përmbushur këto kërkesa themelore.




Figura: Kërkesa e llojeve të iktike për habitate

Ekspertë të ndryshëm kanë shqyrtuar ndikimet e zvogëlimit të ujit në trupa ujorë dhe kanë arritur në përfundimin se "sasia e vogël e ujit të mbetur në rrjedhat natyrore pas zhvillimit të HEC-eve apo devijim të ujit në shkallë të gjerë, në fazat fillestare mund të duket të jenë të mjaftueshme, por me kalimin e kohës ato janë të pamjaftueshme për të mbajtur ish ekosistemin ujor të pacënuar.

Ndryshimet afatgjata në gjallesa ujore, qarkullimin dhe jetën e gjallë mund të përfshijnë: (1) ulje në abundancë për shumë popullata të llojeve të ndryshëm; (2) ndërrime midis popullatave në kuptimin e dominacës dhe raporteve midis tyre; (3) ndërhyrje të popullatave generaliste në nicha dhe dhe boshllëqe të ekosistemeve; (4) ardhja e llojeve të reja; dhe (5) shfaqja e bashkësive të llojeve të reja.

Konkluzione të tilla nxjerrin në pah kompleksitetin e sfidave të ekosistemeve ujore dhe gamën e gjerë të ndikimeve të mundshme, direkte apo indirekte, të menjëhershme apo të vonuara, në popullatat ujore. Në këtë kontekst, nuk është e lehtë për të lidhur ndryshimet e vërejtura në popullata dhe faktorët përgjegjës, sepse vlerësimi i proceseve themelore është shumë i vështirë. Përdorimi i preferencave të organizmave lokale për habitate është një mënyrë që përpiqen për të vlerësuar marrëdhëniet midis ndryshimeve hidromorfologjike dhe përgjigjet e bashkësive dhe mund të ndihmojë për të kuptuar se si aktivitetet e njeriut mund të modifikojnë strukturat e popullatave apo bashkësive. Përafrime të tilla mund të ofrojnë ndihmë për të përmirësuar menaxhimin e trupave ujorë në stadi të ndryshme të ndërhyrjeve. Që këtë habitate të peshqve janë zona ose tërësi karakteristikash të cilat i sigurojnë peshkut kushtet e ushqimit, zonat e strehimit, ose përdoren për riprodhimin. Përderisa zonat dhe karakteristika nuk janë gjithmonë në të njëjtin vend, korridoret migratore janë të nevojshme për të lejuar llojet iktike për të lëvizur nga njëri vend në tjetrin.

Ndikimet ne toke (Relievi, siperfaqja, perberja e struktures se tokes, nentoka.)

Ndikimet negative ne tokat e ekosistemit.

Përshkrimi i ndikimeve negativë mjedisorë gjatë dhe pas:

(i)- Ndërtimit të kanalit të derivacionit e të veprës së marrjes. Ndikimi mjedisor do të shfaqet pas gërmimeve të seksioneve të dy kanaleve të derivacionit dhe betonimeve të tyre sipas përmasave të projektuara deri te vepra e marrjes së HEC-it; Së pari, ndikim negativ mjedisor i gërmimeve për çeljen e kanaleve do të jetë prishja lineare e habitatit tokësor në të dy shpatet malorë ku janë piketuar të kalojnë boshtet e kanaleve të derivacionit dhe, në vijim, veshja e faqeve të brëndëshme të këtyre kanaleve me panele betoni. Impakti vijues pasohet nga ngritja e konstruksionit prej betoni të veprës së marrjes e cila do të modifikojë negativisht arkitekturën e peizazhit të virgjër në vëndin e ndërtimit të saj.

(ii)-Instalimit të tubacionit të presionit të turbinës. Ky tubacion i cili do të ketë një gjatësi prej 980 ml, do të vendoset brenda një kanali, boshti i cilit do të shtrihet mbi një tarracë të ndërtuar enkas për këtë proçes. Tubacioni do të përfundojë te turbina e HEC-it.

(iii)-Ndërtimit të godinës së HEC-it. Paraqet të njëjtin ndikim negativ në hapsirën e ndërtimit si dhe në fushpamjen peizazhistike të ekosistemit lumor që shtrihet pranë saj.

Përshkrimi i masave për rehabilitimin e qëndrueshëm të hapsirave e të sipërfaqeve, mbi të cilat do të ndërhyet, për ruajtjen e aspektit peizazhistik të territorit dhe parandalimin e erozionit.

Dy janë masat operacionale ndërhyrëse që janë parashikuar në këtë projekt: E para, pyllëzimi me llojet e dushqeve autoktonë (*Quercus sp.*) e të dy boshteve ku do të shtrihen kanalet e derivacionit si dhe i boshtit të kanait të tubacionit të furnizimit të HEC-it me ujë (Tubacioni i derivacionit dhe tubacioni i presionit te turbinës);

Ndërhyrje me pyllëzime do të kryhen gjithashtu rreth e rrotull ndërtimeve ose mjediseve të instalimeve të pajisjeve të ndryshme të HEC-it dhe, e dyta: Ndërtimi i gardheve tekë anti-erozivë të cilët do të instalohen në pjesë të veçanta të shpateve që do të përshkohen nga tarracat e kanaleve e tubacioneve të HEC-it.

Pyllëzimi i mjediseve të ndikuar

Është parashikuar të mbillen gjithsej 10000 fidanë nga llojet e dushqeve autoktonë (*Quercus sp.*). Prodhimi i fidanëve të këtyre llojeve do të pororsitet në një kohë paraprake nga ana e subjektit të HEC-it. Fidanët lipset të jenë në moshë dy vjeçare, me bukë dheu në rrënjët e tyre të vendosur në qeska të posaçme plastike.

Të gjithë proçeset e nevojshëm për të realizuar pyllëzimet e rekomanduar janë paraqitur në preventivin përkatës. (Shih aneksin më poshtë). Piketimet për çeljen e gropave që do të mbillen me fidanë pyjorë do të bëhen nga një teknik pyjesh me përvojë në këtë fushë i cili do të tërheqë gjithashtu mendimet e ekspertëve të tjerë nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për qarkun e Gjirokastrës.

☒ N.B. Fidanët e dushqeve që do të mbillen në të dy anët e boshteve të kanaleve të derivacionit si dhe të kanalit të tubacionit të turbinës duhet të jenë me moshë dy vjeçare.

Ndërtimi i gardheve tekë anti-erozivë.

Do të kryhet në të gjitha pjesët e sipërfaqeve të skarpave, që parashikohen të jenë në proces gërryerje ose shplarje sipërfaqësore të dherave që do të depozitohen mbi sipërfaqet e tyre pas gërmimeve që do të kryhen për çeljen e të gjithë kanaleve të projektuar. Në skemën e vizatuar për këtë qëllim është mbajtur parasysh shplarja sipërfaqësore e dherave të hedhur përgjatë skarpave të kanaleve. Në këta raste gardhet tekë dhe vendosja e tyre rekomandohet të bëhet sikurse është improvizuar në skemën e theksuar. Edhe në këtë rast, piketimi i vend-vendosjeve të gardheve tekë si dhe zbatimi i përpiktë i teknikës së ndërtimit të tyre, si rregull, udhëhiqet nga një teknik pyjsh me përvojë në këtë fushë. Thëksojmë se hunjtë e gardheve tekë anti-erozivë rekomandohen të jenë 'të gjallë' pra të sapo prodhuar nga drurët, pastaj ata duhet të nguliten menjëherë në tokë, sipas piketave të vendosura paraprakisht; thellësia e nguljes do të jetë 30 cm. Në këtë mënyrë gardhet e gjallë do të kryejnë funksionin e tyre afatgjatë dhe njëkohësisht do të stabilizojnë e do të gjelbërojnë mjediset e skarpave që kërcënohen nga fenomeni negativ i gërryerjeve e i shplarjeve prej reshjeve atmosferike.

Llojet me përparësi prej të cilëve mund të prodhohen hunjtë e gardheve tekë anti-erozivë janë shelgjet autoktonë (shih shelgu i bardhë) që gjenden në shtratin e lumit, janë gjithashtu rrap, vidhi etj..

Për realizimin e këtij operacioni rekomandojmë që ai të kryhet gjatë periudhës së muajit Shkurt.

Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik (Mjedisi social-kulturor dhe ekonomik, perdorimit tokes, perdorimi i burimeve ujore.)

Ndikimi ne mjedisin social-kulturor e ekonomik nga faza e zbatimit te punimeve te ketij projekti, vleresohet te jete pozitive. Kjo per shkak te nivelit te ulet ekonomik te zones dhe rritjes se punesimit e si rrjedhoje edhe te te ardhurave. Do te punesohen shofere, punetore dhe specialsitet te fushave te ndryshme per mirembajtje e mbarevajtje te punimeve. Nje faktor tjetër pozitiv vleresohet te jete permiresimi i furnizimit te rrjetit publik te zones me energji elektrike, si dhe ndonese me impakt me te ulet, rritja e te ardhurave nga taksat vendore te ketij projekti.

Gjate punimeve te ndertimit, mund te kete nje efekt negativ ne peizazh dhe ne zhurma, por keto ndikime te perkohshme. Sipas verifikimit ne terren dhe te dhenave qe na siguron subjekti, nuk jane identifikur toka bujqesore te cilat preken nga punimet e hidrocentralit, nuk ka qendra te banuara ne afersit e tij, nuk preket uji per ujitje, as per perdorim per sporte akuatike, as per uje te pijshem, as per nevoja te tjera te komunitetit, aktiviteti i akuakultures qe zhvillohet aty prane nuk do te cenohet nga sasia e furnizimit me uje, pasi projekti eshte realizuar ne menyre te tille qe e leshon ujin para se te merret nga akiviteti akuakultures. Me sasine e ujit qe do te lejohet ne rrjedhen e perroit gjate dimrit dhe me sasine e plote gjate veres, nuk duhet te cenohet uji per efekt te blegtorise se zones. Do te kete mjaftueshem per te pire uje bagetite e zones.

Gjetja e objekteve arkeologjike gjate punimeve do te ndryshonte rrjedhen e punimeve, ne rast te hasjes se objekteve arkeologjike, subjekti duhet te ndaloje menjehere punimet e te njoftoje autoritetet pergjegjese.

Nje Investim i tille, ndikon ndjeshem ne zhvillimin ekonomik e social-kulturor te zones. Duke marre nje zhvillim zona, ulet mundesia e largimit te popullsise dhe rritet mundesia e investimeve ne infrastrukture, arsim, shendetesi, etj.

Perdorimi i tokes ne kete krahine, kryesisht eshte per blegtori, pronesia fond pyjor/kullosor ne administrim te Bashkise Gjirokaster. Ne rast te pronesise private te tokave, subjekti investitor, ose duhet te mbuloje tubin duke e vendosur ne thellesi e tokat te riperdoren, ose duhet te shpronesoje perfundimisht te gjithë pronaret e tokave duke kryer nje vleresim rigoroz te tyre, sipas vleres se tregut dhe cmimeve reference te percaktuara me ligj. Per kete projekt, ne rast se do te zbatohen te gjitha kushtet teknike dhe ligjore te ndertimit te tij, te kryhen punime rehabilitimi, te punoje me ore te reduktuara pra vetem gjysmen e vitit sic edhe eshte deklaruar ne projekt, nuk vleresohet te shkaktoje probleme te rendesishme ne mjedis dhe nuk pritet te cenoje jeten dhe mireqenien e banoreve te zones. Ne te kundert, ndikimet paraqiten me potencial. Ne kete segment te burimit uxor nuk cenohen vepra ujesjellesi per qendrat e banuara, nuk demtohen rruget e zones, nuk demton linja te furnizimit me energji elektrike. Nga burimet e zones, do te krijohet mundesia e furnizimit me uje per plotesimin e nevojave te punetoreve dhe te ambjenteve te punes. Kryesisht projekti kalon ne prone publike, zone pyjore/kullosore, nuk kemi informacione per prone private ne kete faze te hartimit te raportit te VNM. Ndikimet negative ne mjedisin social-ekonomik konsistojne kryesisht ne demtimin e burimit uxor si nje aset me vlere per zhvillimin e turizimit malor dhe per vlerat ekologjike qe mbart.

Gjendja ekonomike e kesaj krahine paraqitet e ulet, mungesa e tokave bujqesore, por edhe efekti i emigracionit e migracionit ndikon ne kufizimin e zhvillimit rural ne kete zone. Baza e ekonomise se ketyre fshatrave eshte blegtoria, pjeserisht akuakulturat e vaskave te rritjes intensive te troftes dhe te ardhurat nga emigracioni.

Ne kuader te zbatimit te Konventes Aarhus dhe ligjeve vendase ne funksion te zbatimit te saj, rekomandojme qe ky projekt te kryeje nje degjese me publikun me te afert te zones dhe me Njesine e Qeverisjes Vendore, duke i vene ata ne dijeni per projektin qe propozohet te zhvillohet.

Informacion mbi Qëndrat e banuara në zonë

Qëndrat më të aferta të banuara janë fshati Plesat, Kardhiq dhe Prongji. Distanca e zhvillimit te projektit ne lidhje me fshatrat eshte rreth 2km.

Sipas ligjit të ri për ndarjen administrative Bashkia Gjirokastër përfshin edhe një sërë Njësish Administrative që në total arrin në numrin 7, të cilat janë: Gjirokastër, Cepo, Lazarat, Picar, Lunxhëri, Odrije dhe Antigonë.

Njësia Administrative Cepo përfshin qëndrat e banuara si:

Fshatrat; Fushëbardhë, Zhulat, Taroninë, Mashkullorë, Palokastër, Çepun, Kodër, Plesat, Kardhiq, Prongji dhe Humelicë.

Organizimi administrativ sipas ndarjes se re administrative

QARKU GJIROKASTËR

Nr.	Njësi të qeverisjes vendore		Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
	Qarku	Qendra e Qarkut				
			Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë	Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë
					Cepo	Fshatrat: Fushëbardhë, Zibulat, Taroninë, Mashkollorë, Palokastër, Çepina, Kodër, Plesat, Kardhiq, Prongji, Humelicë
					Lazarat	Fshatrat: Lazarat, Kozdhoce
					Picar	Fshatrat: Picar, Shtëpëz, Kolonjë, Golem, Kapariel
					Lunxhëri	Fshatrat: Qesorat, Dhoksat, Këllëz, Mingul, Nokovë, Erind, Gjat, Kakoz, Karijan, Valare
					Odrë	Fshatrat: Andon Poçi, Hurdëknq, Terbuq, Labovë e Madhe, Labovë e Vogël
					Antigonë	Fshatrat: Asun Zeneli, Arshi Lengo, Kaurë, Tiranoslisht, Saraqushit

Pamje e fshatit Kardhiq



Pamje satelitore e zones, ku pasqyrohen edhe qendrat e banuara



Pamja nga aktiviteti i kultivimit te akuakultures ne zonen e Kardhiqit



Impakti ne peizazh

Ndikimi ne peizazh do te jete i perkohshem per fazen e punimeve, pasi te kryhet rehabilitimi i plote i siperfaqeve te demtuara, vleresohet qe impakti ne peizazh dhe ne biodiversitet te ulet ndjeshem dhe me kalimin e kohes te rivendosen ekulibrat natyrore. Bazuar ne pozicionin qe ka perroi, ndikimi ne peizazh do te jete i dukshem, jo vetem nga fshatrat perballe, por edhe nga rruga Kryesore qe do te lidhe Kardhiqin me Delvinen. Per te pasur nje harmoni me mjedisin e zones, ky projekt duhet qe te kryeje rehabilitimin ne masen 100% te siperfaqeve te demtuara, punimet te fillojne paralelisht me fillimin e punimeve dhe te perfundojne plotesisht pas perfundimit te vepres. Keto punime paralelisht me punimet e germimeve dhe ndertimit nenkuptojne marrjen e masave kunder erozionit duke ndertuar prita me gjerdhe druri ose me mure guri te thate e kubike me tela tip gabion. Nje aspekt tjetër i rendesishem per demtimin e peizazhit eshte edhe gjenerimi i nje sasi relativisht te vogel te materialit tokesor qe do te germohet. Ky material mund te perdoret plotesisht ne trasene e kanalit te derivacionit, duke u riperdorur per punime mbushje dhe rehabilitimi. Ne lidhje me kete ceshtje, duhet te kryhet studim i mirefillte dhe i detajuar dhe te merren edhe miratimet perkatese per kete qellim. Gjithashtu, zhvilluesi duhet te respektoje rrjedhen ekologjike gjate sezonit te vjeshtes-dimrit dhe pjeserisht pranveres, nderkohe qe gjate periodhes qershor-tetor ky hidroçentral rekomandohet te mos vihet ne funksion, me qellim ruajtjen e vlerave natyrore dhe pizazhistike te kesaj zone.

Gjatesia e kanalit te derivacionit dhe tubacionit nen presion do te jene respektivisht 850ml dhe 430 ml, distanca relativisht te vogla. Gjate punimeve do te kete demtim te peizazhit te zones, nga germimet dhe humbja e bimesise, heqja e shtreses aktive te tokes dhe vecanerisht humusit, depozitimi i materialit tokesor anesh dhe pergjate kanalit qe do te hapet. Sheshi i parkimit dhe makinerite gjithashtu do te kene efekt ne peizazhin e zones. Duke qene nje projekt teresisht i ekspozuar nga rruga, ne rast se subjekti zbatues dhe investitori (nese nuk eshte i njejti subjekt), nuk tregohen te kujdesshem dhe rigoroz ne zbatimin e kushteve, imapktet mund te jene shqettesues per kalimtarete por edhe per rezidentet.

Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike (Ndryshimi i klimes, emetimi i substancave ozon-holluese, etj.)

Projekti ne vleresim nuk do te perfshije substanca te tilla qe mund te ndikojne ne rritjen e perqendrimit te lendeve ozon-holluese ne atmosfere. Vleresohet vetem lenda djegese e mjeteve te renda te punimeve te germimit, megjithese ne nivele te uleta. Faktor tjetër negativ mund te vleresohet reduktimi i bimesise se zones dhe pakesimi i asimilimit te dioksidit te karbonit e prodhimit te oksigjenit. Nje efekt mund te vleresohet edhe nga reduktimi i rrjedhes natyrale te ujit cka ndikon ne ndryshime te mikroklimes dhe si rrjedhoje edhe te biodiversitetit te zones, kryesisht bimesise.

Sic edhe eshte permendur me siper, ndikimet ne ajer, uje apo edhe toke nga ky projekt jane edhe negative por edhe pozitive, pare kjo ne nje aspekt tjetër te prodhimit te energjise se rinovueshme dhe miqesore me mjedisin. Ne rast se do te krahasonim teknologjine e perdorur per te prodhuar te njejten sasi energjie elektrike nga nje Termoçentral me qymyr, me lende djegese hidrokarbure, apo me lende te rrezikshme radioaktive.

Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitetin e zones se projektit.

Ndikimet ne biodiversitet (Flora dhe fauna)

Ndikimet ne hidrobiologjine e burimit uxor do te jene prezente per sa kohe funksionon edhe Hidrocentrali, keto ndikime momentet me kritike i kane gjate sezonit me thatesire kur prurjet e perroskave/lumenjve jane ne minimumin e tyre. Ne keto sezone, ky hidrocentral, nuk duhet te punoje, ai duhet te fiket rreth fillimit te muajit Qershor dhe te rivihet ne pune ne vjeshte ne muajin Tetor, kjo ne varesi te prurjeve te burimit uxor, te nivelit te rreshjeve. Sipas projektit te paraqitur, ky objekt do te funksionoje rreth 7 muaj/vit (ose 4870 ore/vit). Ne menyre kategorike, nuk duhet te funksionoje gjate muajve me thatesire, si dhe te respektoje prurjen ekologjike e cila te jete minimalisht sa prurja minimale e ketij burimi uxor, dhe jo 4% e prurjes mesatare shumevjecare, sic ka paraqitur ne te dhenat teknike subjekti. Pakesimi i ujit ne shtratin e lumit, ne nje sezon me thatesire, i cili shoqerohet me stine me temperature te larta, pavaresisht distances e shkurter prej rreth 1km te devijimit total, por ne bashkeveprim me projektet e tjera te hidrocentraleve ne kete burim uxor, do te sillte per pasoje ngrohjen e burimit uxor. Ky ndryshim, qofte edhe ne nivele shume te uleta, ndikon ne menyre te ndjeshme ne largimin ose zhdukjen e specieve te ketij habitati, si rrjedhoje edhe te faunes e cila ushqehet me keto lloj speciesh, i ashtuquajhuri zinxhiri ushqimor.

Përshkrimi i faunës në secilin habitat dhe statusit të ruajtjes në rang kombëtar dhe ndërkombëtar të tyre.

Fauna

Shqiponja eshte edhe simboli kombëtar i Shqipërisë. Ky shpend gjendet ne malesine vendase ne lartesine mbi 1500m mbi nivelin e detit.

Elementet Euroaziatike, Holartike, Mesdhetar dhe Ballkanike, dominojne spektrin faunistik te vendit tone. Pyjet e larte te Shqiperise mbajne komunitete gjitaresh te medhenj si Ujku, Ariu, rreqebulli, Dhia e Eger, Kaprolli, etj. Gjithashtu edhe komunitete karakteristike te shpendeve te lidhur me pyjet e virgjere. 756 lloje rruazoresh raportohen deri me sot ne Shqiperi. Raportohen 70 lloje gjitaresh, 323 shpende, 36 reptile dhe 15 amfibe. Shume prej tyre jane lloje te rrezikuara iose te kercenuara. Terreni malor ne brendesi, siguron habitat per gjitaret e medhenj, si Ariu.

Disa prej llojeve më të rëndësishme të shpendëve në vendin tone pervec shqiponjes, përfshijnë: shkaba, capercaillie dhe shpend uji të shumta. Pyjet shqiptare ende mbajnë komunitete të rëndësishme të gjitarëve të mëdhenj si ariu i murrme, ujku gri, dhia e egër dhe derri i egër. Kryesisht në veri, ne zonat malore të vendit gjenden habitatet e fundit ballkanik te mbetur.

Një popullsi kritike e rrezikuar eshte edhe Rrëqebulli Euroaziatik

Larmia dhe pasuria qe ka kjo zone si ne aspktin klimatik , ate te tokave, te flores etj ka krijuar kushte shume te fazorshme per zhvillimin e nje bote shtazore shume te larmishme. Kete gje e deshmon ekzistenca e shume specieve te vecanta sipas karakterit te habitatit. Do te dallonim boten shtazore te shkurreve, te pyjeve te ahut dhe te dushkut ne lartesine boten interesante te kullotave alpine dhe te pak habitateve ujore. Ne habitatet e shkurreve qe jane me pak te zhvilluara e me pak te perhapura dhe te degraduara nga dora e njeriut gjejme: lepuri i eger, cakalli, thelleza, dhe nje sere shpendesh te tjere. Ne habitatet e dushkut qe edhe ky kat eshte i demtuar takohen rralle: Ujku, dhelpra, ketri, urithi, etj. Ne habitatet e pyjeve te ahut dhe te pishes qe jane me te dendura dhe me pak te prekura nga dora e njeriut takohen specie te vecanta: Ariu, Shqiponja, Rrjepulli, miu vogel, urithi, etj.

Ne habitatet e ujrave te kthjelleta dhe te ftohta te ketyre lumenjve takohet trofta e eger dhe disa lloje te tjera peshqish cka e ben kete zone te dallueshme nga zonat e tjera te vendit. E gjithë kjo ,pasuri e botes shtazore dhe me vlera te vecanta ofron kushte per zhvillimin e disa llojeve te turizmit si: sportive, ekologjik, clothes, etj.

Bota shtazore është e pasur. Nga gjitarët takohen ujku, dhelpra, kunadhja, derri i egër, lepuri i egër, ketri etj.

Rreth zones se studimit

Mbulesat bimore

Flora pyjore në brezin fitoklimatik paramalor, nënzona e ngrohtë, përfaqësohet nga: Prralli ose Ngasja (*Quercus coccifera*), Bezga ose Cfaka (*Phlomis fruticosa*); Shkoza e Zezë (*Carpinus orientalis*), Xana (*Spartium junceum*), Ferra (*Rubus ulmifolius*); Kulumria (*Prunus spinosa*); Kulpra (*Clermatis vitalba*);

Në brezin fitoklimatik *castanetum* gjendet si lloj i rrallë indikator, gështenja (*Castanea sativa*), Panja e Malit (*Acer pseudoplatanus*), Krekëza fletngushtë (*Acer monspessulanum*), Frashëri i Bardhe (*Fraxinus ornus*), Bunga (*Quercus petraea*); Qarri (*Quercus cerris*); Bulgri (*Quercus trojana*); Ilqja (*Quercus ilex*); Krifsha e Ndermjetme (*Phillyrea media*); Gorrica (*Pirus amygdaliformis*); Murrizi Njëbërthamësh (*Crataegus monogyna*); Arra, e kultivuar, (*Juglans regia*); Larushka (*Vitis vinifera* var. *silvestris*);

Brezi fitoklimatik malor i zonës së Kardhiqit (brezi pinetum) përfaqësohet kryesisht nga llojet: Bredhi i Greqisë (*Abies cefalonica*); Robulli (*Pinus heldreichii*); Pisha e Zezë (*Pinus nigra*). Në ekosistemin pyjor të shtratit të lumit të Kardhiqit u evidentuan llojet: Rrapi i Orjentit (*Platanus orientalis*); Konopica (*Vitex agnus-castus*); Marina e Kuqe (*Tamarix parvifolia*); Lofata (*Cercis siliquastrum*); Vidhi (*Ulmus campestris*); Shelgu i Bardhë (*Salix alba*).

Flora barishtore përfaqësohet kryesisht nga graminoret dhe nga bar-ndryshmet; Nga grupi i parë u vërejtën disa prej tyre si: Telishi (*Dactylus glomerata*); Tërshëra e Çmendur (*Avena fatua*); Antoksanta Erëmirë (*Anthoxanthum odoratum*); Rudithi i Pyjeve (*Brachypodium silvaticum*). Nga grupi i bishtajoreve nuk u konstaua ndonjë lloj, kjo për shkak të kushteve klimatike ekstremë të periudhës së vëzhgimit të florës (prania e pjesëshme e shtresës së dëborës); Nga grupi i tretë (barndryshmëm) u evidentuan llojet: Sherebeli (*Salvia officinalis*); Bishtmiu Julian (*Micromeria juliana*); Këlkaza (*Arum* sp.); Qumështorja (*Euphorbia helioscopia*); Gjuhëlopa Mjeksore (*Anchusa officinalis*); Barpeshku (*Verbascum* sp.).

Bazuar në intervistat me dy blegtorë të zones, që u takuan rastësisht në zonën e fokusuar të projektit *), aty rriten gjithashtu: Rigoni i Bardhë (*Origanum heracleoticum*); Çaji i Malit (*Sideritis raeseri*); Salepë të ndryshëm (*Orchis* sp.); Bari i Majasëllit (*Teucrium polium*); Arrësi D. i Vogël (*Teucrium chamaedrys*) etj..

Fauna përfaqësohet nga: derri i egër, lepuri i egër, ujku, kaprolli, dhelpra, thëllëza e malit, kunadhja, bufi, korbi, mëllenja, gushkuqi, harabeli shtëpiak etj.

Në intervistat e kryera me dy barinj të lartpërmendur fauna e trevës së Kardhiqit ka ardhur në rënie të vazhdueshme në drejtim të numërit të krerëve të popullatave të zogjëve ose të kafshëve të egra që njihen historikisht si banore autoktone të kësaj hapsire mjedisore. Ky fenomen është rrjedhojë e gjuetisë së paligjeshme që është ushtruar vazhdimisht gjatë tri dekadave të fundit.

BIODIVERSITETI nuk u konstata asnjë lloj i rrallë që mund të shërbente si indikator specifik për eksositemin e marrë në shqyrtim.

** Barinjtë e tufave të dhive që u takuan rastësisht janë: Sokrat Mixha nga fshati Çepun, NjA CEPO dhe Edvin Haxhiu nga fshati Prongji, NjA CEPO.*

Pershkrim i burimit ujqor dhe gjendjes se biodiversitetit.

Lëvizja e ujqit në të gjithë peisazhin dhe pellgun ujqor ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ekologjinë e lumenjve në shkallë të gjërë hapësinore dhe kohore. Madhësia dhe forma e shtratis lumor, shpërndarja e pellgjeve dhe tributarëve, si dhe qëndrueshmëria e substratit, të gjithë këto elemente përcaktohen nga ndërveprimi mes regjimit të rrjedhës dhe të gjeologjisë e natyrës së tokës.

Shumë lloje peshqish shfaqin një preferencë të caktuar për lloje të veçanta të habitatit të tilla si pellgje, përrenj ose zona moçalore. Në mjaft raste pasuria llojore faunistike rritet me rritjen e kompleksitetit të vendbanimit, me thellësinë, shpejtësinë dhe të mbulesës si ndryshoret më të rëndësishme që rregullojnë këtë marrëdhënie. Struktura e përbërjes llojore iktike (dmth, përbërja taksonomike dhe shpeshia e pranisë) është gjithashtu e lidhur fort në strukturën e habitateve. Duke pasur parasysh marrëdhëniet e shpesh cituara në mes të rrjedhës, strukturës së habitateve dhe peshqve, nuk është e çuditshme se modifikime të regjimit të rrjedhjes ndikojnë në larinë biologjike të peshqve dhe organizimin funksional të komuniteteve iktike në lumenjtë me rrjedhje të rregulluar. Lloje të tilla, me kërkesa specifike habitatesh cilësisht të ndryshme për fazën e riprodhimit, lëshimit të vezëve dhe faza të tjera të jetës perballen me stres në fazën e devijimit të burimit ujqor dhe ndryshimin e regjimit hidrologjik. Në këto faze të gjendjes së burimit ujqor, nuk ka ndryime llojore iktike. Specia me e përhapur apo që mund të kultivohet në këto lloje e kushte hidrologjike e të burimit ujqor është Trofta (*Salmo faroides*), ose Mustaku i Ballkanit (*Barbus rebeli*). Gjithashtu, vlen të përmendet edhe Lundërza (*Lutra lutra*) që gjëndet gjatë rrjetit hidrografik të lumit.

Mbetjet e ngurta të prodhuara gjatë kryerjes së punimeve

Nga ky aktivitet si mbetje të ngurta prodhohen vetëm materialet tokësore të cilat do të gërmohen nga skarpata e sipërme e hapjes së trasës së gjurmës së kanalit të derivacionit dhe të tubacionit nën presion. Këto mbetje të ngurta të prodhuara nga gërmimet do të sistemohen të gjitha duke mbushur e mbyllur anët e kanalit dhe të tubacionit. Për këto mbetje të depozituara duhet të kryhet rehabilitimi i plote të tyre duke i mbjelle me bar dhe me bimesi autoktone. Duke qënë se punimet do të kryhen përgjatë shpatit të një kodrine e cila deri diku ka zhvillime dhe infrastrukture rrugore, celja e kësaj traseje do të shoqërohet me demtime të moderuara dhe do të gjenerojë sasi të vogël dheu e mbetjesh të tjera si material tokësor, gurë, mbetje biologjike të bimesisë. Total përlogaritë që sasia e dheut të gërmuar të jetë me e vogël se 5000 m³. Linja e transmetimit të energjisë elektrike do të ndërtohet përgjatë rrugëve automobilistike ekzistuese dhe vlerësohet që ndikimet të jenë minimale. Volumi i gërmimeve do të jetë i moderuar dhe rehabilitimi pritet të jetë me i thjeshtë dhe me pak i kushtueshem për shkak të gjendjes së materialit tokësor dhe strukturës e teksturës së tokës e cila është e pasur me lëndë humusore dhe material të imet tokësor, të pakten një shtresë prej 60-70cm është e tillë. Për këtë projekt, nuk kemi të dhëna se do të hapen rrugë të reja, përveç atyre të trasës së tubacionit nën presion dhe aksesit brenda kantierit të ndërtimit.

Gjithashtu deri ne objekt, do te perdoren rruget ekzistuese, pasi per te shkuar ne vepren e marrjes ka rruge automobilistike ekzistuese dhe gjithashtu godina e HEC-it ndodhet poshte rruges nacionale, prane vaskave te akuakultures. Mbetjet e dheut qe germohet klasifikohen si mbetje te cilat ne VKM nr. 99, date 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" kane kodin 17 05 04 Dhera dhe gurë. Volumet e germimit ne total per projektin perlogariten rreth 5,000 m³.

Per kete projekt, nuk do te kete prodhim te baterive, gomave te automjeteve apo vajra lubrifikante. Keto sherbime, mjetet e firmes ndertuese do ti kryejne ne subjekte e oficina te licencuara ne zone (pergjate rruges kryesore Tepelene-Gjirokaster, ose qytet Tepelene, qytet Gjirokaster). Per kete do te lidhen kontrata sherbimi lokale, nuk do te kete ndertim te ofcinave nga vete subjekti. Gjithashtu furnizimi me karburant i mjeteve do te kryhet me mjete te vogla transporti me bidona, nga ku karburanti do te blihet nga pikat e autorizuara te tregtimit me pakice te tij. Ky aktivitet, nuk prodhon mbetje te rrezikshme te asnje lloji. Mbetjet e germimeve nuk klasifikohen si te rrezikshme. Ato bejne pjese tek mbetjet jo te rrezikshme, ato me kodet pa yll ne katalogun Shqiptar te klasifikimit te mbetjeve.

5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Shkarkimet ne ajer

Gjate punes per ndertimin e ketij Hidrocentrali, germimet per hapjen e trasese per ndertimin e kanalit/tubacionit te derivacionit dhe instalimin e tubacionit nen presion do te ngrihen pluhura, vecanerisht gjate sezonit me thatesire. Keto pluhura, ndikojne negativisht jo vetem ne peizazhin e perkohshem te zones, por edhe ne floren dhe faunen e zones. Depozitimi i pluhurit ne shtrese te madhe ne gjethet e pemeve, shkakton veshtiresi te proceseve jetesore te bimeve, kryesisht ne procesin e fotosintezes dhe te ushqimit te bimeve. Ndikimi ne peizazh konsiston ne ngritjen e pluhurit pergjate trasese se tubacionit dhe ne rruget auto. Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkimeve te gazeve te demshme per ajrin, por keto shkarkime nuk do te jene ne nivele te larta (krahasimisht me shkarkimet qe clirohen nga cdo mjet tjeter transporti qe funksionon me lende djegese hidrokarbure me motorre me djegie te brendshme). Gjate punimeve nuk rezulton se do te kete perdorim te lendeve plasese, vetem perdorim te eskavatoreve dhe te çekiçeve pneumatike. Zhurmat nga mjetet e punes jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonat e banuara, pasi ato ndodhen ne largesi. Kryesisht zhurmat shkaktohen nga germimet e masivit te shkembit kryesisht nga perdorimi i çekiçeve pneumatike aty ku materiali tokesor eshte i forte. Nuk pritet te kete vibrime, sipas projektit te zbatimit, nuk do te perdoren lendet plasese. Tubacioni i presionit do te shtrihet pergjate shpatit te kodrines e cila ndodhet ne anen e majte te lumit kardhiq, pak para se te filloje aktiviteti i rritjes intensive te peshqve qe ndodhet ne kete zone. Punimet do te kryhen ne nje siperfaqe toke me bimesi shkurre, relativisht te zhveshur per kanal in e derivacionit dhe pjeserisht te dendur per tubacionin nen presion, si rrjedhoje parashikohet te kete demtime te siperfaqeve pjore, por ne nivele te moderuara. Rruga e cila do te mundesoje aksesin me mjete transporti per tek objekti i Hidrocentralit, eshte ekzistuese, mund te perdoret rruga qe kalon prane vaskave te akuakultures per tek godina e Hidrocentralit, si dhe rruga e fshatrave dhe shtrati i gjere i lumit per tek vepra e marrjes dhe kanali i derivacionit.

Rruga per tek vepra e marrjes eshte ekzistuese deri aty prane, ndersa transporti i materialeve pergjate kanalit ku do te instalohet kanali dhe tubacioni, do te mundesohet nepermjet trasese qe do te celet per ndertimin e kanalit dhe shtrimin e tubacionit. Gjatesia e kanalit do te jete maksimumi 850 meter lineare, ndersa gjatesia e tubacionit te presionit do te jete rreth 430 meter lineare. Demtimi i bimesise, sado i moderuar te jete (vetem 430m te tubacionit ka bimesi) ndikon ne uljen e cilesise se ajrit, (sepse bimet sherbejne si asimilues te Dioksidit te Karbonit dhe ricikluese te Oksigjenit). Gjate funksionimit te HEC-it, reduktimi i ujit te burimit, mund te ndikojne ne ndryshime te mikroklimes se zones, por ky efekt, vetem ne rast se nuk respektohet rrjedha ekologjike dhe fikja e turbinave gjate stines me thatesire(Qershor-Tetor). Nga te dhenat teknike paraqitet se kjo veper hidrike do te funksionojne rreth shtate muaj te vitit (sipas projektit hidroteknik te paraqitur, do te punohet rreth 4870 ore/vit). Nese do te kryhet edhe rehabilitimi i plote i siperfaqeve pyjore te demtuara, sipas projektit te rehabilitimit, ndikimet do te jene minimale. Rehabilitimi duhet te kryhet gjate dhe pas perfundimit te punimeve ndertimore. Megjithate, per te parandaluar efektin negativ ne mjedis nga punimet ndertimore, duhet te merren masa parandaluese te tilla si ndertimi i pritave ekologjike me dru per te mbajtur dheun e germuar nga traseja, duke mos lejuar perhapjen e tij ne te gjitha shpatin e kodrines dhe te perfundoje ne shtratin e lumit, ku rrjedha ujore e shperndan ate me tej ne burimin ujqor prites.

Ndikimet ne ajer, uje apo edhe toke nga ky projekt jane edhe pozitive, pare kjo ne nje aspekt tjeter te prodhimit te energjise se rinovueshme dhe miqesore me mjedisin. Ne rast se do te krahasonim teknologjine e perdorur per te prodhuar te njejten sasi energjie elektrike nga nje Termocentral me lende djegese qymyr guri, hidrokarbure, apo perdorim me lende te rrezikshme radioaktive, ky lloj instalimi eshte me miqesor me mjedisin.

Linja e transmetimit qe do te ndertohet duke lidhur HEC Plesat me nenstacionin me te afert, nuk do te kete demtime te rendesishme ne mjedis, kjo pasi do te instalohen vetem disa shtylla dhe do te jete linje ajrore per transmetimin e energjise elektrike. Per ndertimin e linjes nuk do te kete germime e hapje rruges te reja, do te perdoren ato ekzistuese. Ndertimi i linjes nuk demton bimesi te larte, nuk eshte linje e tensionit te larte. Per faunen e rajonit nuk perben shqetesim ndertimi i linjes se transmetimit.

Shkarkimet ne ujera

Nga zbatimi dhe funksionimi i ketij projekti, ndikimet ne ujera do te jene prezente dhe te rendesishme. Gjate fazes se kryerjes se punimeve ndertimore, ndikimi ne ujerat siperfaqesore e nentokesore do te vijne si rrjedhoje e punimeve ne siperfaqe per hapjen e trasese dhe instalimin e kanalit te derivacionit dhe tubacionit nen presion. Hasja e burimeve ujore gjate germimeve ose cpimeve, do te shkaktonte daljen ne siperfaqe te ujerave nentokesore, fenomen i cili mund te shoqerohet edhe me erozion e shpelarje te tokes, varferim te ujerave nentokesore dhe ndotjen e ujerave siperfaqesore te burimeve te zones. Per shkak se punimet do te kryhen ne siperfaqe, duke mos kaluar ne asnje rast germimet ne thellesine 5-7m, keto fenomene probablisht nuk jane te mundura. (Keto fenomene jane prezente kryesisht ne rastet e hapjes se tuneleve). Gjate punimeve te ndertimit, mund te ndodhe qe burimi ujqor(Lumi Kardhiq) te kontaminohet me material tokesor duke shkaktuar turbullire te perkohshme (Lende te Ngurte ne Pezulli). Punimet rehabilituese do te minimizonin ndjeshem keto impakte. Gjate funksionimit te Hidrocentralit, do te merret nje sasi uji e cila do te perdoret per prodhimin e energjise elektrike. Kjo sasi uji, ne raport me prurjen mesatare eshte relativisht e larte.

Gjithashtu, sipas projektit të shfrytëzimit do të respektohet rrjedha ekologjike e perroit e cila është perlllogaritur rreth $0.17 \text{ m}^3/\text{sek}$. Që në raport me prurjen mesatare është diku tek 4%. Sasia e nevojshme e ujit gjatë sezonit me thasë, si për çështjet ekologjike ashtu edhe për çështjet e turizmit, bujqësisë, etj, është shumë më e lartë.

Sipas projektit të shfrytëzimit, deklarohet se do të punohet vetëm 4870 orë/vit, pra rreth 7 muaj/vit, kjo në shtrirje kohore për gjatë gjithë vitit!!!. Një ndikim tjetër i rëndësishëm në lidhje me ujërat, është edhe efekti negativ i këtij projekti në hidrobiologjinë lumore (flora dhe fauna ujore). Në rast se do të kryhen punimet rehabilituese në masën e duhur dhe në kohën e duhur, si dhe të respektohet rregullisht periudha e funksionimit pra vetëm 7 muaj/vit në periode të rregullt stinore/vjetore, që do të thotë se 5 muaj nuk duhet të funksionojë fare si central, ndikimet do të jenë minimale dhe nuk vlerësohen me dëmtime të rëndësishme në mjedisin e zonës.

Në këtë burim ujor, për shkak të sasisë së ujit, të relievit të cilësive së ujit, nisur nga kushtet klimatike dhe të regjimit ujor, vlerësohet se ka prani të peshqve, ku specia e ujërave të embla dhe të ftohta malore është trofta, veçanërisht Mustaku i Ballkanit (Barbus rebeli), i cili është specie me status mbrojtjeje. Në këto kushte, ku në mënyrë institucionale nuk ka asnjë informacion për hidrobiologjinë e këtij burimi ujor, veçanërisht për floren iktike, në kushtet kur nuk ka edhe kontakt me studiues privat të cilët të këne kryer studime specifike dhe të këne informacione të sakta nuk kemi, prania e peshqve ose jo, ana sasiore e llojore ngelet në vlerësim teorik, e pa faktuar, por duke ju referuar kushteve mjedisore të këtij burimi ujor, faktit që është dege direkte e Lumit Drinos dhe indirekt e Lumit Vjose, si dhe duke kryer intervista në terren nga banorët e zonës, arrijmë në këtë konkluzion, se ka prani të troftës së eger.

Më sasinë e prurjes ekologjike, e cila sipas llogaritjeve të ligjit aktual në fuqi, nuk justifikon mbijetesën e gjallesave, gjatë sezonit me thasë do të ishte shkatërruese për floren dhe veçanërisht faunën ujore. Në vlerësimin tone, rrjedha ekologjike duhet të jetë në masën 33.33% të prurjes mesatare vjetore. Në këtë rast, prurja ekologjike e pershtatshme do të ishte $1.4 \text{ m}^3/\text{sek}$. Në këto kushte, funksionimi i vepres vetëm gjashtë-shtatë muaj/vit është një faktor pozitiv i cili ruan vlerat ekologjike të këtij burimi ujor dhe do të lejonte zhvillimin e plote të këtij projekti. Përsa i përket burimit ujor kryesor të zonës i cili është Lumi Vjose, ky projekt, në të tilla përmasa. Në pjesën e sipërme të rrjedhës së këtij lumi, vlerësohet të ketë prani të peshqve, kjo pasi është ndër habitatet më të pershtatshme për shumimin e këtyre llojeve peshqish. Megjithatë, për të parandaluar futjen e peshqve në tubacionin nën presion dhe me pas turbinën e si rrjedhojë dëmtimin e tyre, në basenin e presionit/dekantuesin e vepres së marrjes duhet të vendosen rrjeta të imeta. Baseni dekantues shërben si pastrues i ujit nga sendet dhe papasterite dhe njëkohësisht si parandalues i futjes së peshqve në tubacion.

Shkarkimet ne toke. (Mbetjet e ngurta te prodhuara gjate kryerjes se punimeve)

Nga ky aktivitet si mbetje te ngurta prodhohen vetem materialet tokesore te cilat do te germohen nga skarpata e siperme e hapjes se trasese se gjurmes se kanalit te derivacionit dhe te tubacionit nen presion. Keto mbetje te ngurta te prodhuara nga germimet do te sistemohen te gjitha duke mbushur e mbyllur anet e kanalit dhe te tubacionit. Per keto mbetje te depozituara duhet te kryhet rehabilitimi i plote i tyre duke i mbjelle me bar dhe me bimesi autoktone. Duke qene se punimet do te kryhen pergjate shpatit te nje kodrine e cila deri diku ka zhvillime dhe infrastrukture rrugore, celja e kesaj traseje do te shoqerohet me demtime te moderuara dhe do te gjeneroje sasi te vogel dheu e mbetjesh te tjera si material tokesor, gure, mbetje biologjike te bimesise. Total perlllogaritet qe sasia e dheut te germuar te jete me e vogel se 5000 m³. Linja e transmetimit te energjise elektrike do te ndertohet pergjate rrugeve automobilistike ekzistuese dhe vleresohet qe ndikimet te jene minimale. Volumi i germimeve do te jete i moderuar dhe rehabilitimi pritet te jete me i thjeshte dhe me pak i kushtueshem per shkak te gjendjes se materialit tokesor dhe struktures e tekstures se tokes e cila eshte e pasur me lende humusore dhe material te imet tokesor, te pakten nje shtrese prej 60-70cm eshte e tille. Per kete projekt, nuk kemi te dhena se do te hapen rruge te reja, pervec atyre te trasese se tubacionit nen presion dhe aksesit brenda kantierit te ndertimit.

Gjithashtu deri ne objekt, do te perdoren rruget ekzistuese, pasi per te shkuar ne vepren e marrjes ka rruge automobilistike ekzistuese dhe gjithashtu godina e HEC-it ndodhet poshte rruges nacionale, prane vaskave te Akuakultures. Mbetjet e dheut qe germohet klasifikohen si mbetje te cilat ne VKM nr. 99, date 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" kane kodin 17 05 04 *Dhera dhe gurë*. Volumet e germimit ne total per projektin perlllogariten rreth 5,000 m³.

6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimet madhore do te zgjasin per aq kohe sa zgjasin edhe punimet per ndertimin e kesaj vepre hidrike te tilla si Ndertimi i veprave te marrjes, ndertimi i kanalit te derivacionit, ndertimi/instalimi i tubacionit te presionit dhe godines se HEC-it. Keto punime do te zgjasin perafersisht per nje periudhe 1-2 vjeçare nga data e fillimit te punimeve ne terren. Kjo eshte koha normale qe duhet per te punuar me keto vepra, por mund edhe te kete shtyrje te afatit ose perfundim me pare ne kohe, kjo ne varesi edhe te ecurise se punimeve dhe te problematikave administrative qe mund te hasen gjate punimeve. Kjo eshte e vlefshme ne kushte dhe klime normale, por ne rast se do te hasen veshtiresi gjate punimeve(kryesisht gjate dimrit) mund te kete edhe shtyrje te afatit.

Keto ndikime ne mjedisin e zones duhet te shoqerohen me punime kunder erozionit dhe rehabilitimi te bimesise. Keto punimev duhet te realizohen menjehere pas perfundimit te punimeve ndertimore, por edhe paralelisht me punimet e ndertimit. Ndikimet ne hidrobiologjine e burimit uxor do te jene prezente per sa kohe funksionon edhe Hidrocentrali, keto ndikime momentet me kritike i kane gjate sezonit me thatesire kur prurjet e perroskave/lumenjve jane ne minimumin e tyre. Ne keto sezone, ky hidrocentral, nuk duhet te punoje, ai duhet te fiket rreth fillimit te muajit Qershor dhe te rivihet ne pune ne vjeshte ne muajin Tetor, kjo ne varesi te prurjeve te burimit uxor, te nivelit te rreshjeve. Sipas projektit te paraqitur, ky objekt do te funksionoje rreth 7 muaj/vit (ose 4870 ore/vit). Ne menyre kategorike, nuk duhet te funksionoje gjate muajve me thatesire, si dhe te respektoje prurjen ekologjike e cila te jete minimalisht sa prurja minimale e ketij burimi uxor, dhe jo 4% e prurjes mesatare shumevjeçare, sic ka paraqitur ne te dhenat teknike subjekti. Pakesimi i ujit ne shtratin e lumit, ne nje sezon me thatesire, i cili shoqerohet me stine me temperature te larta, pavaresisht distances e shkurter prej rreth 1km te devijimit total, por ne bashkeveprim me projektet e tjera te hidrocentraleve ne kete burim uxor, do te sillte per pasoje ngrohjen e burimit uxor. Ky ndryshim, qofte edhe ne nivele shume te uleta, ndikon ne menyre te ndjeshme ne largimin ose zhdukjen e specieve te ketij habitati, si rrjedhoje edhe te faunes e cila ushqehet me keto lloj speciesh, i ashtuquajhuri zinxhiri ushqimor.

7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedisin e zones do te kete efektet e tij ne nje distance jo shume te madhe, por per zonen perreth, persa i perkete ndikimeve ne toke dhe bimesi. Ndersa ndikimet ne mjedisin uxor, shtrihen me gjere ne hapesire, per shkak te largimit te nje sasie uji nga shtrati i lumit dhe shkaktimi i turbullires se burimit uxor gjate puunimeve te ndertimit. Ky ndikim do te jete i perkohshem dhe nuk eshte me veti akumuluese ne mjedis. Nuk shkarkohen elemente te demshem per mjedisin, si ne ate uxor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin, kjo eshte e vlefshme vetem nese kryhen me sukses dhe ne masen 100% masat e punimeve rehabilituese dhe te mbrojtjes nga erozioni. Ndikimi ne peizazh do te jete i perkohshem per fazen e punimeve, pasi te kryhet rehabilitimi i plote i siperfaqeve te demtuara, vleresohet qe impakti ne peizazh dhe ne biodiversitet te ulet ndjeshem dhe me kalimin e kohes te rivendosen ekulibrat natyrore. Bazuar ne pozicionin qe ka perroi, ndikimi ne peizazh nuk do te jete shume i shtriire ne hapesire, por per shkak te pranise se ruges Kryesore Kardhiq-Delvine, e cila shtrihet pergjate nje pjese te kesaj Lugine, vleresohet qe impaktet ne peizazh te jene te perkohshme port e konsiderueshme.

Per te pasur nje harmoni me mjedisin e zones, ky projekt, duhet qe te kryeje rehabilitimin ne masen 100% te siperfaqeve te demtuara, punimet te fillojne paralelisht me fillimin e punimeve dhe te perfundojne plotesisht pas perfundimit te vepres. Keto punime paralelisht me punimet e germimeve dhe ndertimit nenkuptojne marrjen e masave kunder erozionit duke ndertuar prita me gjerdhe druri ose me mure guri te thate e gabion. Gjithashtu, zhvilluesi te respektoje rrjedhen ekologjike gjate sezonit te vjeshtes-dimrit dhe pjeserisht pranveres, nderkohe qe gjate periudhes qershor-tetor ky hidrocentral rekomandohet te mos vihet ne funksion, me qellim ruajtjen e vlerave natyrore te kesaj zone pizazhistike.

8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Projekti i rehabilitimit mjedisor, i hartuar nga eksperti perkatës, përmban planifikimin e ndërhyrjeve të nevojshme ingjinerike që synojnë ruajtjen dhe përmirësimin e peizazhit në shpatet e majtë të dy degëzimeve të rrjedhës së Lumit të Kardhiqit në të cilët do të shtrihen kanalet e derivacionit të ujërave që do të bashkohen te vepra e marrjes, në dalje të së cilës do të fillojë kanali kryesor ku do të instalohet tubacioni i presionit të trubinës së HEC-it. Hapsirat lineare të këtyre kanaleve si dhe hapsira ndërtimore e godinës së HEC-it janë objete të fokusuar në këtë projekt për rehabilitim mjedisor. Gjatë vëzhgimeve që u bënë në terren, për grumbullimin e elementëve studimorë të ekosistemit, ingjinerët u përqëndruan te kategoria e zonës fitoklimatike, në përbërjet llojore të mbulesave pyjore e atyre barishtore, tipet dhe nëntipet e tokave, veçoritë pedologjike të tyre etj.. Një drejtim tjetër ku u përqëndrua vëmendja ishte fauna e pranishme në zonë, biodiversiteti dhe komunitetet e blegtorëve që mbarështojnë blegtori autoktone në fshatrat rrotull.

Përshkrimi ekskursionist i ekosistemit pyjor dhe i peizazhit në terrenin e fokusuar.

pozicioni gjeografik i pellgut ujëmbledhës

Zona e Kardhiqit shtrihet në veri-perëndim të qytetit të Gjirokastrës, rreth 22 km larg tij në rrugë tokësore. Koordinatat e vendshtirjes së zonës janë:

1. Veri:.....Përroi i Piksit. (koordinatat: x⁴⁴ 15 838.61; y⁴⁴ 42 129.87)
2. Lindje:..... Përroi i Qafë Mollës. (koordinatat: x⁴⁴ 18 376.85; y⁴⁴ 44 41 829.74)
3. Jug:..... Maja Kershait, 1782.8 m..(koordinatat: x⁴⁴ 20 254.80; y⁴⁴ 44 87 696.53)
4. Perëndim:.....Qafa e Skërficës, 812.0 m.. (koordinatat: x⁴⁴ 15 392.70; y⁴⁴ 44 37 319.22).

Peizazhi

Hapsira e pellgut ujëmbledhës të Lumit të Kardhiqit rrethohet nga male të cilët përshkohen ndërmjet tyre prej dy luginave të degëzimeve të epërme të lumit si dhe prej shtratit të lumit. Për shkak të kundrejtmeve të ndryshëm, shpatet e maleve dallohen ndërmjet tyre nga mbulesa të ndryshme pyjore. Shpatet me kundrejtme verior e veri-lindor janë të veshur me pyje të dendur në përbërjet llojore të të cilëve kryesojnë dushqet dhe shkurret mesdhetare gjetherënëse; shpatet jugorë paraqiten të varfër në mbulesa pyjore; atje gjenden të përhapur, kryesisht, dy llojet e njohur të brezit fitoklimatik mesdhetar me klimë të ngrohtë: bezga dhe driza që rriten në hapsirat e kullotave dimërore të kësaj zone deri në lartësitë 400-500 m. mbi nivelin e detit.

Sipërfaqja e përgjithshme e zonës është rreth 1800 ha.. Ajo është shpallur 'rezervat natyror strikt i mbrojtur me vendimin e këshillit të ministrave: VKM nr. 102 date 15.01.1996.

Peizazhi i zonës së Kardhiqit është mjaft tërheqës e me vlera të spikatura për zhvillimin e ekoturizmit malor e të turizmit edukatf.

Relievi bën pjesë në kategorinë pellg ujëmbledhës malor, në boshtin e të cilit shtrihet shtrati i lumit të Kardhiqit me dy degëzimet e tij skajore që shtrihen në veri-perëndim e në perëndim të territorit. Shpatet malorë kanë valëzime me pjerrësi të përafërt, uniforme gjë që i ka veshur ata me një pamje të bukur peizazhistike.


Tokat

Në përgjithësi hapsira e pellgut ujëmbledhës e lumit të Kardhiqit dallohet për toka të tipit 'E Hinjtë-Kafe' të cilat ngrihen mbi formacionë shkëmborë rano-argjilorë që vendosen në trajtë shistes shtresorë të hollë e të shkërrmoqshëm. Ky formacion tokësor e ka prejardhjen nga shtresat sedimentare ranore që janë formuar në periudhën gjeologjike të kuaternarit. Përveç këtyre formacioneve, aty gjenden gjithashtu shkëmbj gelqerorë konglomeratë mbi të cilët shtrihen toka të kafejta malore me strukturë gjysëm-skeletike.

Në përgjithësi profilet pedologjikë paraqiten me thellësi të luhatëshme duke filluar nga thellësia 50 cm, për tokat e tipit të kafejta malore e shtrihen deri në thellësitë e mëdha të profileve të tokave të hinjta-kafe të cilët praktikisht emërtohen si 'profile të thellë' pasi tejkalojnë treguesin pedologjik 130 cm.

Strukturat e tokave në përgjithësi paraqiten kokrrizore mesatare ose të imëta ndërsa teksturat e tyre janë SAM, gjë e cila dëshmon për përmbajtjen e dukëshme të grimcave ranore në raport me përmbajtjen e argjilës së pastër.

Përsa i përket pasurisë mineralogjike dhe asaj organike te shtresat e sipërme të profileve të tokave në këtë hapsirë territoriale, mund të formulojmë një vlerësim të tërthortë duke u bazuar te zhvillimi vegjetatif i mbulesave bimore në përgjithësi, te shkalla e mbulimit sipërfaqësor etj. pra, mund të theksojmë se, një pjesë e tokave në këtë hapsirë të territorit janë potencialisht të pasura me elementë mineralë dhe njëkohësisht me lëndë organike; këto të fundit ri-ciklohen periodikisht në çdo sipërfaqe pyjore si rrjedhojë e procesit natyral të podhimit e të purifikimit të përvitshëm të gjethëve të drurëve e shkurreve që kanë formuar shtresat e njohura të lëgushave pyjore ose 'mantelin jetdhënës' të tokës për mijëra gjallesa të dukëshme e të padukëshme në planetin tonë.



Mbulesat bimore

Flora pyjore në brezin fitoklimatik paramalor, nënzona e ngrohtë, përfaqësohet nga: Prralli ose Ngasja (*Quercus coccifera*), Bezga ose Cfaka (*Phlomis fruticosa*); Shkoza e Zezë (*Carpinus orientalis*), Xana (*Spartium junceum*), Ferra (*Rubus ulmifolius*); Kulumria (*Prunus spinosa*); Kulpra (*Clermatis vitalba*);

Në brezin fitoklimatik *castanetum* gjendet si lloj i rrallë indikator, gështenja (*Castanea sativa*), Panja e Malit (*Acer pseudoplatanus*), Krekëza fletngushtë (*Acer monspessulanum*), Frashëri i Bardhe (*Fraxinus ornus*), Bunga (*Quercus petraea*); Qarri (*Quercus cerris*); Bulgri (*Quercus trojana*); Ilqja (*Quercus ilex*); Krifsha e Ndermjetme (*Phillyrea media*); Gorrica (*Pirus amygdaliformis*); Murrizi Njëbërthamësh (*Crataegus monogyna*); Arra, e kultivuar, (*Juglans regia*); Larushka (*Vitis vinifera* var. *silvestris*);

Brezi fitoklimatik malor i zonës së Kardhiqit (brezi pinetum) përfaqësohet kryesisht nga llojet: Bredhi i Greqisë (*Abies cefalonica*); Robulli (*Pinus heldreichii*); Pisha e Zezë (*Pinus nigra*).

Në ekosistemin pyjor të shtratit të lumit të Kardhiqit u evidentuan llojet: Rrapi i Orjentit (*Platanus orientalis*); Konopica (*Vitex agnus-castus*); Marina e Kuqe (*Tamarix parvifolia*); Lofata (*Cercis siliquastrum*); Vidhi (*Ulmus campestris*); Shelgu i Bardhë (*Salix alba*).

Flora barishtore përfaqësohet kryesisht nga graminoret dhe nga bar-ndryshmet; Nga grupi i parë u vërejtën disa prej tyre si: Telishi (*Dactylus glomerata*); Tërshëra e Çmendur (*Avena fatua*); Antoksanta Erëmirë (*Anthoxanthum odoratum*); Rudithi i Pyjeve (*Brachypodium silvaticum*). Nga grupi i bishtajoreve nuk u konstaua ndonjë lloj, kjo për shkak të kushteve klimatike ekstremë të periudhës së vëzhgimit të florës (prania e pjesëshme e shtresës së dëborës); Nga grupi i tretë (barndryshmëm) u evidentuan llojet: Sherebeli (*Salvia officinalis*); Bishtmiu Julian (*Micromeria juliana*); Këlkaza (*Arum* sp.); Qumështorja (*Euphorbia helioscopia*); Gjuhëlopa Mjeksore (*Anchusa officinalis*); Barpeshku (*Verbascum* sp.).

Bazuar në intervistat me dy blegtorë të zones, që u takuan rastësisht në zonën e fokusuar të projektit ^{*}, aty rriten gjithashtu: Rigoni i Bardhë (*Origanum heracleoticum*); Çaji i Malit (*Sideritis raeseri*); Salepë të ndryshëm (*Orchis* sp.); Bari i Majasëllit (*Teucrium polium*); Arrësi D. i Vogël (*Teucrium chamaedrys*) etj..

Fauna përfaqësohet nga: derri i egër, lepuri i egër, ujku, kaprolli, dhelpra, thëllëza e malit, kunadhja, bufi, korbi, mëllenja, gushkuqi, harabeli shtëpiak etj.

Në intervistat e kryera me dy barinj të lartpërmendur fauna e trevës së Kardhiqit ka ardhur në rënie të vazhdueshme në drejtim të numërit të krerëve të popullatave të zogjve ose të kafshëve të egra që njihen historikisht si banore autoktone të kësaj hapsire mjedisore. Ky fenomen është rrjedhojë e gjuetisë së paligjësme që është ushtruar vazhdimisht gjatë tri dekadave të fundit.

BIODIVERSITETI nuk u konstata anje lloj i rrallë që mund të shërbente si indikator specifik për eksositemin e marrë në shqyrtim.

^{*} Barinjtë e tufave të dhive që u takuan rastësisht janë: Sokrat Mixha nga fshati Çepun, NjA CEPO dhe Edvin Haxhiu nga fshati Prongji, NjA CEPO.



Përshkrimi i ndikimeve negativë mjedisorë gjatë dhe pas:

(i)- Ndërtimit të dy kanaleve të derivacionit e të veprës së marrjes. Ndikimi mjedisor do të shfaqet pas gërmimeve të seksioneve të dy kanaleve të derivacionit dhe betonimeve të tyre sipas përmasave të projektuara deri te vepra e marrjes së HEC-it; Së pari, ndikim negativ mjedisor i gërmimeve për çeljen e kanaleve do të jetë prishja lineare e habitatit tokësor në të dy shpatet malorë ku janë piketuar të kalojnë boshtet e kanaleve të derivacionit dhe, në vijim, veshja e faqeve të brëndëshme të këtyre kanaleve me panele betoni. Impakti vijues pasohet nga ngritja e konstruksionit prej betoni të veprës së marrjes e cila do të modifikojë negativisht arkitekturën e peizazhit të virgjër në vëndin e ndërtimit të saj.

(ii)-Instalimit të tubacionit të presionit të turbinës. Ky tubacion i cili do të ketë një gjatësi prej 980 ml, do të vendoset brenda një kanali, boshti i cilit do të shtrihet mbi një tarracë të ndërtuar enkas për këtë proces. Tubacioni do të përfundojë te turbina e HEC-it.

(iii)-Ndërtimit të godinës së HEC-it. Paraqet të njëjtin ndikim negativ në hapsirën e ndërtimit si dhe në fushpamjen peizazhistike të ekosistemit lumor që shtrihet pranë saj.

Përshkrimi i masave për rehabilitimin e qëndrueshëm të hapsirave e të sipërfaqeve, mbi të cilat do të ndërhyet, për ruajtjen e aspektit peizazhistik të territorit dhe parandalimin e erozionit.

Dy janë masat operationale ndërhyrëse që janë parashikuar në këtë projekt: E para, pyllëzimi me llojet e dushqeve autoktonë (*Quercus sp.*) e të dy boshteve ku do të shtrihen kanalet e derivacionit si dhe i boshtit të kanait të tubacionit të furnizimit të HEC-it me ujë (Tubacioni i derivacionit dhe tubacioni i presionit te turbinës);

Ndërhyrje me pyllëzime do të kryhen gjithashtu rreth e rrotull ndërtimeve ose mjediseve të instalimeve të pajisjeve të ndryshme të HEC-it dhe, e dyta: Ndërtimi i gardheve tekë anti-erozivë të cilët do të instalohen në pjesë të veçanta të shpateve që do të përshkohen nga tarracat e kanaleve e tubacioneve të HEC-it.

Pyllëzimi i mjediseve të ndikuar Është parashikuar të mbillen gjithsej 10000 fidanë nga llojet e dushqeve autoktonë (*Quercus sp.*). Prodhimi i fidanëve të këtyre llojeve do të pororsitet në një kohë paraprake nga ana e subjektit të HEC-it. Fidanët lipset të jenë në moshë dy vjeçare, me bukë dheu në rrënjët e tyre të vendosur në qeska të posaçme plastike.

Të gjithë proceset e nevojshëm për të realizuar pyllëzimet e rekomanduar janë paraqitur në preventivin përkatës. (Shih aneksin më poshtë). Piketimet për çeljen e gropave që do të mbillen me fidanë pyjorë do të bëhen nga një teknik pyjesh me përvojë në këtë fushë i cili do të tërheqë gjithashtu mendimet e ekspertëve të tjerë nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për qarkun e Gjirokastrës.

➤ **N.B.** *Fidanët e dushqeve që do të mbillen në të dy anët e boshteve të kanaleve të derivacionit si dhe të kanalit të tubacionit të turbinës duhet të jenë me moshë dy vjeçare.*

Ndërtimi i gardheve tekë anti-erozivë Do të kryhet në të gjitha pjesët e sipërfaqeve të skarpave, që parashikohen të jenë në proces gërryerje ose shplarje sipërfaqësore të dherave që do të depozitohen mbi sipërfaqet e tyre pas gërmimeve që do të kryhen për çeljen e të gjithë kanaleve të projektuar. Në skemën e vizatuar për këtë qëllim është mbajtur parasysh shplarja sipërfaqësore e dherave të hedhur përgjatë skarpave të kanaleve. Në këta raste gardhet tekë dhe vendosja e tyre rekomandohet të bëhet sikurse është improvizuar në skemën e theksuar. Edhe në këtë rast, piketimi i vend-vendosjeve të gardheve tekë si dhe zbatimi i përpiktë i teknikës së ndërtimit të tyre, si rregull, udhëhiqet

nga një teknik pyjesh me përvojë në këtë fushë. Theksojmë se hunjët e gardheve tekë anti-erozivë rekomandohen të jenë 'të gjallë' pra të sapo prodhuar nga drurët, pastaj ata duhet të nguliten menjëherë në tokë, sipas piketave të vendosura paraprakisht; thellësia e nguljes do të jetë 30 cm. Në këtë mënyrë *gardhet e gjallë* do të kryejnë funksionin e tyre afatgjatë dhe njëkohësisht do të stabilizojnë e do të gjelbërojnë mjediset e skarpave që kërcënohen nga fenomeni negativ i gërryerjeve e i shplarjeve prej reshjeve atmosferike.

Llojet me përparësi prej të cilëve mund të prodhohen hunjët e gardheve tekë anti-erozivë janë shelgjet autoktonë (shih shelgu i bardhë) që gjenden në shtratin e lumit, janë gjithashtu rrapi, vidhi etj..

Për realizimin e këtij operacioni rekomandojmë që ai të kryhet gjatë periudhës së muajit Shkurt.

Republika e Shqipërisë Qarku Gjirokastrë
Bashkia Gjirokastrë NjA CEPO
Pellgu ujëmbledhës i Lumit të Kardhiqit

PREVENTIV nr. 1

Pyllëzim me llojet e dushqeve (Shparth, Bulgër, Qarr)

indeksi Manualit	Përshkrimi i operacioneve që do të kryhen	Njësia e matjes	Vëllimi i punës që do të kryhet	Norma për një D/P	Kategoria e pagesës në lekë	Vlera në lekë
225-2	Piketimis sheshesh me nivel	sheshe	10000	150	2000	133333
227-9	Përgatitje sheshesh 1x0.6 m.. Tokë me fortësi mesatare	sheshe	10000	25	2000	800000
223-6	Çelje gropash 50x50x50 cm..Tokë me fortësi mesatare	Gropa	10000	25	2000	800000
224-16	Mbjellje fidanësh të përgatitur në qeska plastamsi, në gropa me madhësi 50x50x50 cm.	Fidanë	10000	60	2000	333333
228-3	Prashtije e tëharrje (3 herë gjatë periudhës pranverore-verore), me shtatë, e fidanëve të mbjellë. Rrezja e prashitjes nga fidani: 30 cm.	Fidanë	10000	250	1750	70000
227-11	Transport fidanësh me qeska 1-2 vjeçarë (me tokë) në krah deri në largësinë 500 ml	Fidanë	10000	100	1750	175000
	Shuma e I	Lekë				2311667
	Kontribut për sigurimet shoqërore 21.7%	Lekë				501632
	Shuma e II	Lekë				2813298
	Kostua e fidanëve + transp.	Fidanë	10000	1.00	50	500000
	Shuma e III	Lekë				3313298
	Shpenzime administrative 3%	Lekë				99399
	Kostua totale e pyllëzimit	Lekë				3412697

**) Normat dhe çmimet përkatës janë marrë nga manuali shtetëror*

HARTOI:

Ingj. Ferdin Liçaj

Firma, vula

Ekspert i çertifikuar

Republika e Shqipërisë Qarku Gjirokastrë
Bashkia Gjirokastrë NjA CEPO
Pellgu ujëmbledhës i Lumit të Kardhiqit
Republika e Shqipërisë Qarku Gjirokastrë

PREVENTIV nr. 2

Ndërtim gardhesh tekë anti-erozif. Llogartitur për 3000 m² gardh tek

Indeksi i Manualit	Përshkrimi i aktiviteteve që do të kryhen	Njësia e natjes	Vëllimi i punës që do të kryhet	Norma për një D/P	kategoria e pagesës	Vlera në lekë
242-2	Prodhim hunjsh, 1.5 m të gjatë dhe 8-10 cm trashësi nga shelgjet, rrapi, plepat; transporti i tyre në vendin e grumbullimit deri 100 ml.	copë	500	60	1000	8333
242-3	Prodhim shufrash 1.5-2m të gjata dhe transporti i tyre në vendin e grumbullimit deri 100 ml.	copë	5000	1500	1000	3333
242-5	Bërja e majave të hunjëve me diametër 4-8 cm	copë	500	500	700	700
242-6	Hapje gropash me qysqi 30 cm thellë për ngulje hunjsh	copë	500	300	1000	1667
243-9	Thurje gardhi me shufra të ngjeshura	m ²	100	10	1000	10000
	Shuma e parë	Lekë				24033
	Kontribut për sig. shoqërore 21.7%	Lekë				5215
	Shuma e dytë	Lekë				29249
	Shpenzime administrative 3%	Lekë				877
	Shuma e pestë:	Lekë				30126
	Vlera totale për 100 m ² gardh tek	Lekë				30126
	Vlera totale për 3000 m ² gardh tek	Lekë				903780


PREVENTIVUES:

Ingj. Ferdin LIÇAJ

Ekspert i çertifikuar



MODELI I GARDHIT VEGJETATIF ANTI-EROZIF
Hunj shelgu me diametër 6-8 cm; prejja e hunjëve do të bëhet me pak pjerrësinë të dy anët duke përdorur instrumente shumë të mprehtë. Periudha: MARS



Monitorimi

Rekomandohet të bëhet periodikisht pas çdo ndërhyrje dhe për çdo masë që do të ndërmerret në drejtim të rehabilitimit ose të përmirësimit të mjedisit e të peizazhit. Ai do të kryhet nga zyra e menaxhimit të pyjeve në bashkinë e Gjirokastrës, AKZM e qarkut të Gjirokastrës në bashkëpunim me shoqatën e përdoruesve të pyjeve/kullotave komunale që operon në territorin e Nj.A. CEPO, bashkia Gjirokastrë.

Monitorimi do të përfshijë dy aspektet kryesorë të procesit të cilët janë:

Fillim dhe përfundim i ndërhyrjeve operacionale rehabilituese brënda periudhave të theksuara në këtë projekt;

Zbatim i përpiktë i teknologjive të rekomanduara për çdo ndërhyrje operacionale;

Situacione për punime të kryer dhe fatura financiare të likujduara nga investitori.

Rezultatet e përfituar periodikisht do i raportohen zyrës së menaxhimit të pyjeve në bashkinë e Gjirokastrës dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për qarkun e Gjirokastrës.

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Masa parandaluese te rekomanduara per ndikimet ne ajer

Aplikimi i lagies se kantierit/rrugeve me uje gjate sezonit me thatesire per te reduktuar pluhurat. Perdorimi i mjeteve bashkekohore dhe me kriter e brenda kushteve teknike. Perdorimi i mjeteve dhe materialeve cilesore e eficiente. Monitorim i cilesise se ajrit gjate fazes se punimeve. Menaxhim i materialit tokesor te depozituar dhe te sheshit te grumbullimit te shtreses se humusit. Ky projekt ndikon ne mjedisin biologjik te zones. Kete efekt mund ta reduktoje vetem zbatimi i projektit te rehabilitimit ne menyre rigoroze dhe te detajuar te siperfaqeve te demtuara. Keto punime duhet te kryhen sa me shpejte te jete e mundur dhe te mos lihen te hapura per nje kohe te gjate. Mbjellja e bimesise se re ne raport 1 me 3. Subjekti te kryej nje menaxhim te mire te dheut dhe te filloje punimet rehabilituese paralelisht me punimet e hapjes ne vende te tjera, ne menyre qe te shmangen impaktet ne peizazh. Per kete projekt i gjithe segmenti i punimeve te shoqerohet me punime lehtesisht te maskueshem me vegjetacion apo material tokesore. Edhe per ndertesen e hidrocentralit dhe vepren e marrjes mund te kryhen punime maskuese dhe rehabilituese duke reduktuar keshtu maksimalisht impaktin ne peizazh. Ndertimi i linjes se transmetimit do te kete impakte te pjesshme dhe vetem gjate ndertimit, pasi gjate funksionimit nuk perben problem per faunen e eger. Linja nuk do te jete e tensionit te larte te cilat krijojne nje sere problemesh mjedisore.

Nga te dhenat teknike paraqitet se kjo veper hidrike do te funksionoje rreth gjashte-shtate muaj te vitit (sipas projektit hidroteknik te paraqitur, do te punohet rreth 4870 ore/vit). Nese do te kryhet edhe rehabilitimi i plote i siperfaqeve pyjore te demtuara, ndikimet do te jene minimale. Rehabilitimi duhet te kryhet gjate dhe pas perfundimit te punimeve ndertimore. Megjithate, per te parandaluar efektin negativ ne mjedis nga punimet ndertimore, duhet te merren masa parandaluese te tilla si ndertimi i pritave ekologjike me dru per te mbajtur dheun e germuar nga traseja, duke mos lejuar perhapjen e tij ne te gjithe shpatin e malit dhe te perfundoje ne perrua, ku rrjedha ujore e shperndan ate me tej ne burimin ujqor prites. Ndikimet ne ajer, uje apo edhe toke nga ky projekt jane edhe pozitive, pare kjo ne nje aspekt tjetër te prodhimit te energjise se rinovueshme dhe miqesore me mjedisin. Ne rast se do te krahasonim teknologjine e perdorur per te prodhuar te njejten sasi energjie elektrike nga nje Termocentral me lende djegese qymyr, hidrokarbure, apo me lende te rrezikshme radioaktive.

Masa parandaluese te rekomanduara per ndikimet ne uje

Nga zbatimi dhe funksionimi i ketij projekti, ndikimet ne ujera do te jene prezente dhe te rendesishme. Gjate fazes se kryerjes se punimeve ndertimore, ndikimi ne ujerat siperfaqesore e nentokesore do te vijne si rrjedhoje e punimeve ne siperfaqe per hapjen e trasese dhe instalimin e kanalit te derivacionit dhe tubacionit nen presion. Hasja e burimeve ujore gjate germimeve ose cpimeve, do te shkaktonte daljen ne siperfaqe te ujerave nentokesore, fenomen i cili mund te shoqerohet edhe me erozion e shpelarje te tokes, varferim te ujerave nentokesore dhe ndotjen e ujerave siperfaqesore te burimeve te zones. Per shkak se punimet do te kryhen ne siperfaqe, duke mos kaluar ne asnje rast germimet ne thellesine 5-7m, keto fenomene probablisht nuk jane te mundura. (Keto fenomene jane prezente kryesisht ne rastet e hapjes se tuneleve).

Gjate punimeve te ndertimit, mund te ndodhe qe burimi uJOR(Lumi Kardhiq) te kontaminohet me material tokesor duke shkaktuar turbullire te perkohshme (Lende te Ngurte ne Pezulli). Punimet rehabilituese do te minimizonin ndjeshem keto impakte. Gjate funksionimit te Hidrocentralit, do te merret nje sasi uji e cila do te perdoret per prodhimin e energjise elektrike. Kjo sasi uji, ne raport me prurjen mesatare eshte relativisht e larte.

Gjithashtu, sipas projektit te shfrytezimit do te respektohet rrjedha ekologjike e perroit e cila eshte perlloritur rreth $0.17 \text{ m}^3/\text{sek}$. Qe ne raport me prurjen mesatare eshte diku tek 4%. Sasia e nevojshme e ujit gjate sezonit me thatesire, si per ceshtjet ekologjike ashtu edhe per ceshtjet e turizmit, bujqesise, etj, eshte shume me e larte.

Sipas projektit te shfrytezimit, deklarohet se do te punohet vetem 4870 ore/vit, pra rreth 7 muaj/vit, kjo ne shtrirje kohore per gjate gjithë vitit!!!. Nje ndikim tjetër i rendesishem ne lidhje me ujerat, eshte edhe efekti negativ i ketij projekti ne hidrobiologjine lumore(flora dhe fauna ujore). Ne rast se do te kryhen punimet rehabilituese ne masen e duhur dhe ne kohen e duhur, si dhe te respektohet rregullisht periudha e funksionimit pra vetem 7 muaj/vit ne periode te rregullt stinore/vjetore, qe do te thote se 5 muaj nuk duhet te funksionojë fare si central, ndikimet do te jene minimale dhe nuk vleresohen me demtime te rendesishme ne mjedisin e zones.

Ne kete burim uJOR, per shkak te sasise se ujit, te relievit e cilesise se ujit, nisur nga kushtet kimaterike dhe te regjimit uJOR, vleresohet se ka prani te peshqve, ku specia e ujerave te embla dhe te ftohta malore eshte trofta, veçanerisht Mustaku i Ballkanit (Barbus rebeli), i cili eshte specie me status mbrojtjeje. Ne keto kushte, ku ne menyre institucionale nuk ka asnje informacion per hidrobiologjine e ketij burimi uJOR, veçanerisht per floren iktike, ne kushtet kur nuk ka edhe kontakt me studiues privat te cilet te kene kryer studime specifike dhe te kene informacione te sakta nuk kemi, prania e peshqve ose jo, ana sasiore e llojore ngelet ne vleresim teorik, e pa faktuar, por duke ju referuar kushteve mjedisore te ketij burimi uJOR, faktit qe eshte dege direkte e Lumit Drinos dhe indirekt e Lumit Vjose, si dhe duke kryer intervista ne terren nga banoret e zones, arrijme ne kete konkluzion, se ka prani te troftes se eger.

Me sasine e prurjes ekologjike, e cila sipas llogaritjeve te ligjit aktual ne fuqi, nuk justifikon mbijetesën e gjallesave, gjate sezonit me thatesire do te ishte shkaterruese per floren dhe vecanerisht faunen ujore. Ne vleresimin tone, rrjedha ekologjike duhet te jete ne masen 33.33% te prurjes mesatare vjetore. Ne kete rast, prurja ekologjike e pershtatshme do te ishte $1.4 \text{ m}^3/\text{sek}$. Ne keto kushte, funksionimi i vepres vetem gjashte-shtate muaj/vit eshte nje faktor pozitiv i cili ruan vlerat ekologjike te ketij burimi uJOR dhe do te lejonte zhvillimin e plote te ketij projekti. Persa i perkete burimit uJOR kryesor te zones i cili eshte Lumi Vjose, ky projekt, ne te tilla permasa. Ne pjesen e siperme te rrjedhes se ketij lumi, vleresohet te kete prani te peshqve, kjo pasi eshte nder habitatet me te pershtatshme per shumimin e ketyre lloj peshqish. Megjithate, per te parandaluar futjen e peshqve ne tubacionin nen presion dhe me pas turbinen e si rrjedhoje demtimin e tyre, ne basenin e presionit/dekantuesin e vepres se marrjes duhet te vendosen rrjeta te imeta. Baseni dekantues sherben si pastrues i ujit nga sendet dhe papasterite dhe njekohesisht si parandalues i futjes se peshqve ne tubacion.

Masa parandaluese te rekomanduara per ndikimet ne toke

Ndikimet negative ne tokat e ekosistemit.

Përshkrimi i ndikimeve negativë mjedisorë gjatë dhe pas:

(i)- Ndërtimit të kanalit të derivacionit e të veprës së marrjes. Ndikimi mjedisor do të shfaqet pas gërmimeve të seksioneve të dy kanaleve të derivacionit dhe betonimeve të tyre sipas përmasave të projektuara deri te vepra e marrjes së HEC-it; Së pari, ndikim negativ mjedisor i gërmimeve për çeljen e kanaleve do të jetë prishja lineare e habitatit tokësor në të dy shpatet malorë ku janë piketuar të kalojnë boshtet e kanaleve të derivacionit dhe, në vijim, veshja e faqeve të brëndëshme të këtyre kanaleve me panele betoni. Impakti vijues pasohet nga ngritja e konstruksionit prej betoni të veprës së marrjes e cila do të modifikojë negativisht arkitekturën e peizazhit të virgjër në vëndin e ndërtimit të saj.

(ii)-Instalimit të tubacionit të presionit të turbinës. Ky tubacion i cili do të ketë një gjatësi prej 980 ml, do të vendoset brenda një kanali, boshti i cilit do të shtrihet mbi një tarracë të ndërtuar enkas për këtë proces. Tubacioni do të përfundojë te turbina e HEC-it.

(iii)-Ndërtimit të godinës së HEC-it. Paraqet të njëjtin ndikim negativ në hapsirën e ndërtimit si dhe në fushpamjen peizazhistike të ekosistemit lumor që shtrihet pranë saj.

Përshkrimi i masave për rehabilitimin e qëndrueshëm të hapsirave e të sipërfaqeve, mbi të cilat do të ndërhyet, për ruajtjen e aspektit peizazhistik të territorit dhe parandalimin e erozionit.

Dy janë masat operacionale ndërhyrëse që janë parashikuar në këtë projekt: E para, pyllëzimi me llojet e dushqeve autoktonë (Quercus sp.) e të dy boshteve ku do të shtrihen kanalet e derivacionit si dhe i boshtit të kanait të tubacionit të furnizimit të HEC-it me ujë (Tubacioni i derivacionit dhe tubacioni i presionit te turbinës);

Ndërhyrje me pyllëzime do të kryhen gjithashtu rreth e rrotull ndërtimeve ose mjediseve të instalimeve të pajisjeve të ndryshme të HEC-it dhe, e dyta: Ndërtimi i gardheve tekë anti-erozivë të cilët do të instalohen në pjesë të veçanta të shpateve që do të përshkohen nga tarracat e kanaleve e tubacioneve të HEC-it.

Pyllëzimi i mjediseve të ndikuar

Është parashikuar të mbillen gjithsej 10000 fidanë nga llojet e dushqeve autoktonë (Quercus sp.). Prodhimi i fidanëve të këtyre llojeve do të pororsitet në një kohë paraprake nga ana e subjektit të HEC-it. Fidanët lipset të jenë në moshë dy vjeçare, me bukë dheu në rrënjët e tyre të vendosur në qeska të posaçme plastike.

Të gjithë proceset e nevojshëm për të realizuar pyllëzimet e rekomanduar janë paraqitur në preventivin përkatës. (Shih aneksin më poshtë). Piketimet për çeljen e gropave që do të mbillen me fidanë pyjorë do të bëhen nga një teknik pyjesh me përvojë në këtë fushë i cili do të tërheqë gjithashtu mendimet e ekspertëve të tjerë nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për qarkun e Gjirokastrës.

N.B. Fidanët e dushqeve që do të mbillen në të dy anët e boshteve të kanaleve të derivacionit si dhe të kanalit të tubacionit të turbinës duhet të jenë me moshë dy vjeçare.

Ndërtimi i gardheve tekë anti-erozivë.

Do të kryhet në të gjitha pjesët e sipërfaqeve të skarpatave, që parashikohen të jenë në proces gërryerje ose shplarje sipërfaqësore të dherave që do të depozitohen mbi sipërfaqet e tyre pas gërmimeve që do të kryhen për çeljen e të gjithë kanaleve të projektuar. Në skemën e vizatuar për këtë qëllim është mbajtur parasysh shplarja sipërfaqësore e dherave të hedhur përgjatë skarpateve të kanaleve. Në këta raste gardhet tekë dhe vendosja e tyre rekomandohet të bëhet sikurse është improvizuar në skemën e theksuar. Edhe në këtë rast, piketimi i vend-vendosjeve të gardheve tekë si dhe zbatimi i përpiktë i teknikës së ndërtimit të tyre, si rregull, udhëhiqet nga një teknik pyjesh me përvojë në këtë fushë. Thëksojmë se hunjët e gardheve tekë anti-erozivë rekomandohen të jenë 'të gjallë' pra të sapo prodhuar nga drurët, pastaj ata duhet të nguliten menjëherë në tokë, sipas piketave të vendosura paraprakisht; thellësia e nguljes do të jetë 30 cm. Në këtë mënyrë gardhet e gjallë do të kryejnë funksionin e tyre afatgjatë dhe njëkohësisht do të stabilizojnë e do të gjelbërojnë mjediset e skarpatave që kërcënohen nga fenomeni negativ i gërryerjeve e i shplarjeve prej reshjeve atmosferike.

Llojet me përparësi prej të cilëve mund të prodhohen hunjët e gardheve tekë anti-erozivë janë shelgjet autoktonë (shih shelgu i bardhë) që gjënden në shtratin e lumit, janë gjithashtu rrapë, vidhi etj..

Për realizimin e këtij operacioni rekomandojmë që ai të kryhet gjatë periudhës së muajit Shkurt.

REKOMANDIME:

Ne mënyrë të përgjithshme paraqesim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori ose nenkontratuesit për zbatimin e projektit. Ndikimet negative në mjedis gjatë zbatimit të projektit janë shumë të rëndësishme dhe me impakt potencial. Si rrjedhojë, gjykojmë se janë tepër të nevojshme që në vija të përgjithshme të kihet parasysh dhe të ndermerren disa masa nga kompania ndërtuese/investitori me qëllim mbrojtjen sa më shumë të jetë e mundur të mjedisit natyror. Gjithashtu, gjatë funksionimit të vepres ndikimet në mjedis nga devijimi i rrjedhës së ujit janë të rëndësishme dhe në lidhje me këto paraqesim disa rekomandime.

Nder masa të tjera parandaluese, minimizuese, rehabilituese, permisuese të ndikimit në mjedis rekomandojmë:

- Lagia e shesheve dhe kantierit gjatë punimeve të ndërtimit dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri për të minimizuar ngritjen e grimcave të ngurta (pluhurave) në ajër.
- Të sistemohet dhe rehabilitohen të gjitha skarpatat dhe të kryhen punime mbrojtëse nga erozioni dhe efekti gërryerës i lumit.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara dhe në rruget e pa asfaltuara.
- Gjatë transportit të perdoren mushamate e kamionave për të shmangur përhapjen e dheut e të inerteve në rruget e qendrave të banuara dhe të rrugëve nacionale.
- Të respektohen 100% masat e percaktuara në projektin e rehabilitimit të sipërfaqeve mjedisore të demtuara. Rehabilitimi të fillojë qysh në fillim të punimeve për ndërtimin e vepres duke filluar me punime mbajtëse dhe mbrojtëse ndaj erozionit të skarpatave që do të hapen dhe për menaxhimin e mbetjeve inerte të germuara në trasenë e tubacionit.

- Materialet e germuara nga skarpatat e traseja e kanalit/tubacionit, te sistemohen dhe rehabilitohen pergjate trasese ne gjurmen e vete kanalit dhe ku do te instalohet tubacioni nen presion.
- Subjekti te mbjelle peme te larta ne te gjithë perimetrin e godines se hidrocentralit dhe pergjate gjithë gjatesise prej 850 ml te kanalit dhe 430ml te tubacionit me qellim reduktimin e impaktit ne peizazh(per shkak te pranise se rruges nacionale, ky imakt pritet te kete efekte negative te konsiderueshme tek perdoruesit e kesaj rruge).
- Subjekti te kryeje nje inventar te gjithë pemeve te demtuara dhe te kryeje rimbjelljen e tyre ne raport 1:3 ne zona te percaktuara si problematike nga shteti.
- Subjekti te monitoroje ecurine e mbjelljeve qe do te kryeje.
- Subjekti duhet te kujdeset qe te mos kete renie zjarri ne zonen pyjore.
- Para se te filloje punen hidrocentrali, subjekti te largoje nga terreni i punes te gjitha mjetet dhe pajisjet apo mbetjet e ngurta te perdorura gjate ndertimit.
- Subjekti ka pergjegjesine e plote te rehabilitoje te gjitha siperfaqet e demtuara.
- Subjekti duhet te raportoje ne menyre periodike cdo 6 muaj prane AKM per zbatimin e kushteve te Vendimit te miratimit te VNM paraprake apo deklarates mjedisore.
- Para prerjes se pemeve pyjore, te largohen nepermjet zhurmave te gjitha gjallesat e botes shtazore te ketij habitati.
- Te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te punes ne kantier.
- Te respektohet ne menyre strikte sasia e rrjedhes ekologjike dhe e nevojave te komunitetit per ujitje apo blegtori, ose per aktivitete te tjera ekzistuese. Te fiken turbinat gjate sezonit me thatesire per 5-6 muaj sipas deklarimit te subjektit dhe percaktimit ne te dhenat teknike dhe te mos cenoje ne asnje moment ujin per nevojat ekologjike te mbijeteses se flores dhe faunes uJOR por edhe asaj te eger malore. Gjithashtu, edhe duke lene te gjithë rrjedhen ne shtratin natyral gjate stines me thatesire, me qellim mos cenimin e biodiversitetit dhe zhvillimit te eko-turizmit malor ne kete zone.
- Te shpronsohen dhe te vleresohen ne masen e duhur te gjithë pronaret te cilet pronat e tyre preken nga ndertimi i kesaj vepre hidroelektrike.
- Te punesohen banore te zones ne kete investim dhe te paguhen rregullisht taksat vendore e ato qendrore.
- Para fillimit te punimeve ndertimore, subjekti ne ndjeke te gjitha procedurat per heqjen apo zvogelimin nga fondi pyjor te siperfaqeve qe do te preken.

10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR.

Ky projekt nuk ndodhet prane kufirit shtetëror, nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shtetëror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.



REPUBLIKA E SHqipërisë
 Ministria e Financave dhe Ekonomisë
 Qendra Kombëtare e Rregullimit

LICENCE

Numri serial: LN-4856-04-2018
 NUIS/NIPT: L81509036M

Subjekti: STUDIO REA-G

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Rruga "Ali Demi", pallati nr 70, shkalla nr 6, apartamenti 74, regjistruar ne Zyren e Regjistrimit Tirane, Zona Kadastrale 8150, Pasuria me numer 7/49+6-54, vol. 6, fq. 232

Kodi: III.2.A (1+2) **Kod tjetër:**

Data e lëshimit: 06/04/2018 **Afati i vlefshmërisë:** Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtarië e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

Tëj VNTM PARAPRAKË

1. Ndikim në mjedis

2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Instalime për prodhimin e energji elektrike dhe ujit të nxehtë dhe ftohje

Hydroelektrike (HEC) (PARK SHQIPËRIE), PERIODI I

B. GJITROKASTËR

Nënshkrimi i sportelit

Qendra Kombëtare e Rregullimit

Qendror

REPUBLICA E SHqipërisë - REPUBLIKË E SHqipërisë

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

QKB

14

14

Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprerjet detyrimi ligjor për të qenë personi i autorizuar të ushtrojë licencën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë. Tel. 04 224 572 Fax. 0 4 270 627 www.moe.gov.al

Nr. 224 Prot.

Tiranë, më 20.04.2006

Vendimi nr. 3, Nr. 178 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Agim PASHAJ

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

Të VMM PAPA PRAKE

Subjekti "MAGNA ENERGY" SHPK

*"HEC PLESAT", I PDDHUR NE PERROJ I
REHONES DHE LUFTI KARDHIQ BIRROVA*

Agim Pashaj

MINISTRI

L. Illy

Luftër XHUV

